




A është

HOLY
BIBLE

Bibla

Fjalë e Zotit?

Ahmed Didat

*Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshiruesit!*

A është Bibla Fjalë e Zotit?

Ahmet Didati

Botim Privat

Tabela e përmbajtjes

Kaptina I.....	6
Ç’THONË ATA NJË RRËFIM KRISHTER	6
ZOTI NA RUAJTË KISHËN NGA PRIFTËRIJTË E KËTILLË! ..	8
TË SHURDHËR, MEMECË DHE TË VERBËR, ATA NUK DUAN TË KTHEHEN NË RRUGË TË DREJTË.....	9
Kaptina II.....	10
PIKËPAMJET MUSLIMANE MENDJEMADHËSIA KRISHTERE	10
PYETJE KËMBËNGULSE	10
TRI SHKALLË TË PROVAVE.....	11
TIPI I PARË	12
TIPI I DYTË.....	12
TIPI I TRETË	13
KAPTINA III	15
VERSIONET E SHUMËFISHTA TË BIBLËS.....	15
NDARJA E GRURIT NGA KASHTA	15
BIBLA KATOLIKE.....	18
BIBLA PROTESTANTE	19
ADMIRIMET E ZJARRTA	20
LIBRAT MË TË KËRKUARA NË BOTË.....	21
P A R A T H Ë N J E.....	22
KAPTINA IV	27
P E S Ë D H J E T Ë M I J Ë G A B I M E (?).....	27
Z G J O H U N I	27
I L I N D U R N G A Z O T I E J O I K R I J U A R.....	31

MATEMATIKA MESIANE KRISHTERE	32
TË NGJITURIT NË QIELL	34
NJË CIRK ME GOMAR.....	36
JO PËRGJITHMONË	36
Kaptina e V.....	40
BESIMI I MALLKUAR.....	40
SËMUNDJE E PËRHAPUR.....	40
NË SOFËR (TAVOLINË) ÇKA KA QËLLUAR.....	42
MUSAI (MOZESI) SHKRUAN NEKROLOGUN E VET.....	44
Kaptina e VI	45
LIBRI I PAGËZUAR “DHJATA E RE”	45
BIBLAT E PËRKRYERA NË ANGLISHTËN MODERNE NGA J. B. PHILLIPS.....	49
BIBLA E MATEUT	49
LONDËR XHOFRI BLES (GEOFFREY BLES) PLAGJIATURË ME SHUMICË	50
PLAGJIATURË A VJEDHJE LETRARE	51
STANDARDET E SH TREMBËRUARA	52
HIQ MË PAK SE 100%.....	52
ASNJË INSPIRIM VERBAL.....	54
KAPTINA VII	55
TESTI PA SHIJE.....	55
ZOTI APO SHEJTANI	55
KUSH JANË AUTORËT E VËRTETË?.....	59
TRE APO SHTATË?	59
TETË APO TETËMBËDHJETË?.....	59

KALORËSI APO KËMBËSORI?	60
ÇKA KA CAKTUAR ZOTI: TRE VJET URIE APO SHTATË?	61
SA VJEQAR ISHTE JEHOJAKINI, 8 APO 18?	61
ZOTI E NGATËRROI “KALORËSINË” DHE “KËMBËSORINË!	63
DETYRAT PRAKTIKE TË SHTËPISË.....	63
ÇFARË HIGJENE?	64
NJË SËRË KONTRADIKTASH	65
DALLIMI “2000 DHE 3000 ËSHTË VETËM PËR 50% I RRITUR!	65
DALLIMI NË MES 4 MIJË DHE 40 MIJË ËSHTË VETËM 36.000!.....	67
HEBRENJTË NUK KANË PËRDORUR “O” NË TESMENTIN E VJETËR.....	68
DËSHMIA MË OBJEKTIVE	68
JO FORT LARG PËR TU KËRKUAR.....	70
DËNIM!.....	70
HAKMARRJA E GRUAS	71
NJË MËSIM MORAL.....	72
DILEMAT PRINDËRORE KRISHTERE	72
Kaptina VIII	75
INCEST I “NDERUAR”	75
NDALOJE JIBRIN.....	77
VAJZAT MASHTROJNË BABËN E TYRE	78
Kaptina IX	80
GENEALOGJIA E JEZUIT	80

TË PARËT TË PANDERSHËM.....	80
VETËM DY TË POROSITUR	81
PROFECIA E PLOTË?	81
JEZUI	83
THYERJA E PARAGJYKIMIT	83
BURIMIT I “INSPIRIMIT” TË LUKËS.	85
PSE LUKA E SHKROI “UNGJILIN E TIJ”?.....	86
UNGJILLI SIPAS SHËN LUKËS	86
UNGJILLI QË KA MBETUR.....	87
AUTORËT NË NJË LËVOZHGË ARRE	87
LIBRAT E BIBLËS	90
EPILOGU	94
PROVOKIM I HERSHËM	94
MYSLIMANËT PËRHERË TË ATAKUAR	95
ATAKU NUK ISHTE I RI.....	96
A KANË MYSLIMANËT PËRGJIGJE?.....	98
MYSLIMANËT THËRRASIN NË GARË.....	98

Kaptina I

Ç'THONË ATA NJË RRËFIM KRISHTER

Dr. W. Graham Scroggie (Graham Skrogi) nga Instituti i Biblës Mudi (Moodi), Çikago, njeri me prestigj më të lartë i botës së Misionit Krishter Evangjelik, duke u përgjigjur në pyetje:” A është Bibla fjalë e Zotit ?” (poashtu një titull të tillë e mban libri i tij), në kapitullin përmbledhës thotë: E njeriut është por është hyjnor. Në faqen 17 ai thekson:

Po, Bibla është e njeriut, mirëpo nuk është në frymën e të kuptuarit,¹ gjë që ia humbë vlerën. Këto libra² janë të shkruara ashtu qysh njerëzit i kanë kuptuar, me gjuhen e njerëzve, me penda të duarve të tyre, të cilat bartin stilin karakteristik të njerëzve. (Nënvizimet janë të mia).

Një erudit tjetër krishter, Kenneth Cragg (Keneth krag), Ipeshkëv Anglikan në Jeruzalem, në faqen 277 të librit të tij Thirrja nga minarja”, thekson “Nuk është kështu Dhjata e Re”³ ...Aty ka kondenzime dhe fjalë të ndryshme të futura në tekst sipas zgjedhjes si reproduktime dhe dëshmi.⁴ Ungjiit janë përpiluar sipas mendimeve të Kishës pas shpinës së autorëve. Kjo ka qenë një

¹ Jo nga mosdija

² Bibla nuk është vetëm një libër. Është një zgjedhje dhe një kompilim i shumë librave.

³ E kundërt me Kur'an.

⁴ Fjalë dhe tekste të futura në Bibël.

eksperiencë historikisht e vërtetuar.⁵

Nëse fjalët kanë domethënie të duhur, a ka nevojë që ne t'u shtojmë ndonjë kuptim tjetër ose ndonjë koment për ta Vërtetuar rastin? Jo! Por, propagandistët profesionist, pas llomotitjeve që kanë bërë, ende mendojnë se kanë fytyrë që t'i bindin lexuesit që mos të dyshojnë fare në atë se Bibla është “Fjalë e Zotit”. Gjimnastikat semantike të fjalëve të shtrembëruara nga ana e tyre, me të vërtetë janë të çuditshme!

Të dy doktorët e religjionit me një gjuhë të kuptuar, shikuar njerëzisht, janë duke na thënë se ekzistojnë mundësi që Bibla është vepër e njeriut, përkundër tentimeve të tyre që të na na bindin se kjo është Fjalë e Zotit. Një thënie e vjetër arabe thotë:

⁵ Vlerësimi Është imi.

ZOTI NA RUAJTË KISHËN NGA PRIFTËRIJTË E KËTILLË!

Në këtë drejtim, priftërinjtë dhe biblistat e flakët janë të “inspiruar” që të ngarendin në ‘pafesi’⁶. Një student i teologjisë , evangjelistë ende i pakualifikuar, nga Universiteti i Witvatersrandit, rregullisht vizitonte xhaminë në Njuton të Johannesburgut, por kishte mendim”të lartë“ për ‘dëshmi’⁷ të anëtarëve të kongregacionit të vet. Pasi që iu prezentova (duke e parë se dëshiron), e ftova për drekë në shtëpinë e vëllezërve të mij, jo larg nga xhamia. Gjatë drekës bisedonim për autencitetin e Biblës dhe dogmatizmin kokëfortë dhe të ndjeshëm të tij.

Me qëllim ia përmenda këtë: Se”profesori i juaj Geyser (Gejser), shef i Departamentit të Teologjisë, nuk beson se Bibla është “Fjalë e Zotit”. Pa një befasi të dukshme m’u përgjigj: “E di”. Por, unë personalisht asgjë nuk di rreth bindjes së profesorit që ka për biblën. Vetëm ia ceka disa kundërthënie të tij të shprehura në librin: “Hyjnia e Krishtit”. Para disa kohëve ka pasur me disa besimtarë të devotshëm një polemikë. Mandej, vazhdova duke i thënë: “Mësimdhënësi i juaj nuk beson se Bibla është Fjalë e Zotit”. Evangjelisti i ri m’u përgjigj prap me atë “E di”, por tani filloi të më thotë se “unë besoj” se Bibla është “Fjalë e Zotit”⁸ Me të vërtetë për këta njerëz nuk mund të gjendet ilaçi.

⁶ Shiko veprën: “Si u zhduk mosbesimi?”, nga Dr. Scroggie, Moody press.

⁷ Kur i krishteri flet për “dëshmitë”

⁸ Kjo gjë nuk është kontestuese.

Kjo sëmundje do ta habiste edhe Jezusin: “shikojnë por nuk shohin, dëgjojnë por nuk ndiejnë, ata asgjë nuk kuptojnë” (Mateu, 13:3).

Libri i Shenjtë i Zotit Kur’ani e dënon këtë mentalitet të kryeneqësisë, me këto ajete:

TË SHURDHËR, MEMECË DHE TË VERBËR, ATA NUK DUAN TË KTHEHEN NË RRUGË TË DREJTË

Këto fjalë u dedikohen njerëzve që kanë besim të singertë, të cilët janë me devotshmëri të interesuar për ta gjetur Dritën e Zotit, dhe me këto synime të jenë të udhëhequr. Kurse për palën tjetër shpirtërisht të sëmurë, faktet e shtrura këtu sa vijnë dhe e shtojnë sëmundjet e zemrave të tyre.

Kaptina II

PIKËPAMJET MUSLIMANE MENDJEMADHËSIA KRISHTERE

Cilado që të jetë nga 1001sekte krishtere, katolike, protestante apo “kultiste” që i përkasin Krishterimit, kurrë tek ata nuk gjeni asnjë misionar i cili nuk do ta merr me mend “prima facie” se fuqia e bindjes pranon Biblën e tij të Shenjtë, si libër i përkryer të cilin duhet ta pranojë i tërë opinioni besimtar? Përgjigjja e vetme për këtë prozelitizëm për bindje është se duhet lexuar versetet e Biblës, të cilat janë plotë kundërshtime me interpretimet e misionarëve.

PYETJE KËMBËNGULSE

Kur një musliman i paraqet pikëpamjet e veta për Librin e Shenjtë të krishterëve, dhe kur një prift profesional, famullitar, ose predikues nuk është në gjendje t'i hedhë poshtë argumentet, por edhe nuk i shmanget pyetjes:

“A E PRANONI JU BIBLËN SI FJALË TË ZOTIT”?

Përgjigjja në këtë pyetje është e thjeshtë: “PO” ose “JO, të cilat nuk paraqesin kurrfarë përgjigje. Do ta shihni se ai fillon me shpjegimin e pozitës së vet. Krishteri duke evituar përgjigjen, nuk të jep rast që ta pyesësh kështu diçka. Bëhet nervoz. Ai vetëm insiston në përgjigjen “PO” ose “JO”! Një hebre qe 2000 vjet sillet kështu kur është fjala për Jezusin, përpos çuditërisht, vetëm kur e vesh këmbishën e të çmendurit, ashtu qysh sot është në modë!

Lexuesi plotësisht do të pajtohet se gjërat nuk duhet gjithmonë të shikohen Zi ose Bardh. Në mes të këtyre dy ngjyrave ekstreme gjenden edhe hijet e ngjyrave të përhimëta. Nëse ju përgjigjeni në pyetjen e tij me “PO”, kjo do të thotë se jeni gati të përbini në grep me konop ose një lavjerrës muratori, kur ta lexoni librin “Genesis to Revalation” gjeni me “JO”, ai menjëherë do të ikë nga faktet që ja keni parashtruar dhe i përkrahur nga bashkëbesimtarët e tij, në këtë përgjigje do të thotë “A po e shihni se ky njeri nuk i beson Biblës sonë? Me çfarë të drejte ky rastin nga Libri ynë na e shpjegon në këtë mënyrë? ”Me këtë salto në ujë ai mbetet i kënaqur që shëndoshë e mirë del nga kjo grackë. Çfarë duhet bërë një Mubalig në këtë rast? Duhet ta shpjegojë pozitën e vet ndaj Biblës ashtu si duhet.

TRI SHKALLË TË PROVAVE

Neve myslimanët, pa ndonjë përgatitje të veçantë nuk hezitojmë të pranojmë se në Bibël gjenden tri lloje të dëshmive të njohura. Këto janë:

1. Ju jeni të aftë ta dini se në Bibël çka do të thotë “BOTA E ZOTIT”?
2. Poashtu duhet ta dalloni se çka përshkruhet me “FJALA E PROFETIT TË ZOTIT”
3. Pastaj, menjëherë do të vëreni se në çfarë mase Bibla është e ngarkuar me shënime të dëshmive që kanë parë ose dëgjuar, ose

që dikush ka shkruar për atë që ka dëgjuar. Si të tilla ato janë
“FJALËT E NJË HISTORIANI”

Ju nga këta shembuj nuk mund t’i kuptoni shënimet me
prejardhje të ndryshme që janë shkruar në Bibël. Shembujt e
mëposhtëm na e sqarojnë situatën:

TIPI I PARË

a) Unë atë do ta ngre në shkallën e një profeti... dhe Unë do
t’i fus aty fjalët e mia... dhe ai do të flet përmes tyre, dhe unë do të
udhëheqi me të. (Deuteronomy, 18:18)

b) Unë, pos që jam sundimtar, pos Meje nuk ka tjetër
shpëtimtar (Isai, 43:11)

c) Besoni në Mua, se do të jeni të shpëtuar, derisa do t’i vjen
fundi i botës.

Ndaj, Unë jam Zot e askush tjetër! (Isaia, 45:22)

Vëreni vetën e parë njëjës në referencat e lartpërmendura, dhe
shumë më lehtë mund ta konkludon se ky fakt na tregon se
ndoshta këto fjalë janë “Fjalët E ZOTIT”

TIPI I DYTË

a) “A qante Jezui me zë duke thënë Eli, Eli lama sabahtani”?
(Mateu, 27:46)

b) “Jezui i përgjigjej atij: Urdhëri më i parë është “Dëgjo o Israel: Sundimtari, Zoti ynë është një“ (Marku, 12:29)

c) “Dhe Jezui thotë: Përse mua më quani Zot? Ai, i cili, është një është vetëm Zoti”(Marku, 10:18)

Edhe një fëmijë do të ishte në gjendje ta pranojë këtë fakt: Jezui “bërtiste”, Jezui “përgjigjej” dhe Jezui “tha”, se këto fjalë janë për atë kujt i ngarkohen, p.sh. fjalët e një profeti të Zotit.

TIPI I TRETË

Dhe, duke parë larg një dru fiku që kishte gjelbëruar. Ai (Jezui) vjen me shpresë se do të gjejë diçka në të: dhe kur (Jezui) iu afrua për t’i ngrënë frutat asgjë nuk gjeti në të: përpos gjetheve. (Marku, 11:13).

Në mbrendi të Biblës mund të vërtetohet tipi i Tretë.

Aty janë të shënuara fjalët e vetës së Tretë. Mbani në mend se përemrat e nënvizuar, nuk janë fjalët e Zotit e as profetit të Tij, por vetëm “FJALËT E NJË HISTORIANI”.

Për një musliman është shumë lehtë t’i dallojnë tipet e shënimeve të lartpërmendura, për arsye se ato gjenden edhe në fenë e tij. Por, prej besimtarëve të religjioneve të ndryshme, myslimani është më i lumturi ngase shënimet e ndryshme gjenden në libra të veçanta!

NJË: Lloji i parë- FJALA E ZOTIT – gjendet në Librin e quajtur KUR’ANI I SHENJTË.

DY: Lloji i dytë - FJALËT E TË DËRGUARIT TË

ZOTIT – (Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Te) janë të shënuara në LIBRAT E TRADITËS, të quajtura HADITHE!

TRE: Shënimet e llojit të tretë me të madhe hasen në vëllimet e ndryshme të Historisë islame, të shkruara nga autoritetet më të larta shkencore, dhe atyre me famë më të vogël, por një musliman, sipas këshillave që u përmbahet, këto libra i mbanë në vëllime të veqanta!

Ndaj, një musliman shënimet e të tri tipeve, i mbanë të ndara me kujdes, sipas gradës së çdo autoriteti që i ka shkruar. Ai, këto libra kurr nuk i trajton njësoj. Në anën tjetër,” Bibla e Shenjët”është përplot me literaturë të ndryshme, të cilat e ngarkojnë shumë ngase nuk kanë kurrfarë vlere – të gjitha këto nën një kopertinë - dhe kështu një i krishter është i detyruar t’i pranojë si shkrimeme vlere dhe rëndësi të njëjtë shpirtërore, dhe në këtë kuptim, i krishteri me kete veti ia ka mbyllur fatin.

KAPTINA III

VERSIONET E SHUMËFISHTA TË BIBLËS

Të bëhet një analizë e bindjes së një krishteri rreth Librit të tij të Shenjtë, për neve nuk është gjë e lehtë.

NDARJA E GRURIT NGA KASHTA

Para se të hedhim një sy mbi versionet e Librave të Zotit, të bëjmë një sqarim se si trajtohet ky problem në fenë tonë. Kur themi, se ne i besojmë 'TEVRATIT', 'ZEBURIT', 'UNGJILLIT' DHE 'KUR'ANIT', në realitet çfarë kuptimi paraqet ky besim? Neve jemi të bindur se Kur'ani i Shenjtë është, pa dyshim, Fjalë e Zotit, e dërguar Profeti Tonë Hazreti Muhamed Mustafasë (paqa qoftë mbi Te) fjalë për fjalë, me anën e Xhebrailit (i njohur si Gabriel në anglishte), deri më tani të ruajtura në tërësi nga ndryshimet e mundshme nga ana e njerëzve që 1400 vjet⁹ Megjithëqë Islami ka përjetuar kritika armiqësore dhe qëllimkëqija, ai me kohë ka vërtetuar autencitetin e Kur'anit të Shenjtë. Sir William Muir në shekullin e VIII, pat shkruar këtë mendim për Kur'an:

⁹ Si mysliman ose jomusliman nuk duhet ta pranoni këtë bindje vetëm në mënyrë fetare. Mundeni ta verifikoni këtë edhe me fakt se Kur'ani është ruajtur në një mënyrë Hyjnore, e cila matematikisht është vërtetuar, të cilën gjë mund ta shihni, t'i besoni dhe ta prekni në veprën KUR'ANI MREKULLIA E FUNDIT! (jepet falas)

SIGURISHT SE NË BOTË NUK EKZISTON ASNJË LIBËR AUTENTIK SI QË ËSHTË KUR'ANI ME TEKST TË PANDRYSHUAR, QË I KA PËRJETUAR QE 12 SHEKUJ.

TEVRATI, të cilit neve i besojmë, nuk është TORA e hebrenjëve dhe e krishterëve, edhe pse fjalët në arabishte ose hebraike janë të njejta. Neve i besojmë të gjitha predikimeve që i kanë zbritur me anë të Revelatës së Zotit të Madhërueshëm,

por duhet ditur se Musai nuk ka qenë autor i këtyre “librave” që ia kanë atribuar hebrenjtë dhe krishterët.¹⁰

Poashtu neve na besojnë se ZEBURI ka qenë një Revelatë dhuruar hazreti Davudit, (paqa qoftë mbi Të), por psalmet e sotme nën emrin e tij nuk paraqesin revelatën.¹¹ krishterët vetë nuk insistojnë në atë se Davudi është i vetmi autor i “Psalmeve të tij”

Çka të themi për UNXHILLIN? Ungjilli do të thotë “Evangjele” ose “Lajmet e mira”, për të cilët shkrimtarët thonë se shpesh i ka përdorur Jezui, kur ka folë edhe predikuar gjatë misionit të vet të shkurtë për Ingjilin, sikurse:

1) Dhe Jezui, shkante duke predikuar UNGJILIN ... dhe duke shëruar popullin nga çdo sëmundje. (Mateu, 9:35)

2) ... por kushdo që flijohet për mua dhe UNGJILIN ai do tashpëton vetvetën. (Marku, 8:35)

¹⁰ Më shumë për këtë në faqën 25 të këtij libri, me titull:” MUSAI NUK ËSHTË AUTOR I TORËS BIBLIKE”

¹¹ Shiko faqën 59 “Trusti i Trurëve” rrëfim – autor: Kryesisht Davudi, por aty ka pasur edhe të tjerë shkrimtarë.

3) ... predikonte INXHILIN, (Luka, 20:1)

“Evangeliji” (Ungjili) është fjalë që më shpesh përdoret, por Jezui më çfarë predikonte? Prej 27 librave të dhjatës së re, vetëm një pjesë e vogël mund të pranohet se aty janë fjalët e Jezuit. Krishterët lavdërohen me Ungjillin e Sh. Mateut, me atë të Markut, të Sh. Lukës, dhe atë të Sh. Xhonit, por nuk kanë qenë asnjë Unxhil të Jezuit! Neve SINQERISHT besojmë se të gjitha fjalët që i ka predikuar Krishti (paqa dhe bekimi i Zotit qofshin mbi Të) kanë qenë të Zotit. Ky ka qenë Ungjilli (Ingjili), “Lajmet e Mira” dhe “Udhëzimi i Zotit” për bijtë e Izraelit. Jezui gjatë jetës së tij nuk pat shkruar asnjë fjalë edhe se nuk mësuar asnjë njeri për ta bërë një gjë të tillë. Përse Ungjijtë aktualë paraqesin vepra tënjerezve të panjohur? Para nesh paraqitet kjo pyetje: A PO PRANON PRA SE BIBLA ËSHTË FJALË E ZOTIT? Në të vërtetë pyetja është një çik provokative. Ai, i cili pyet nuk e ka të lehtë ta ndriçoj këtë kërkesë. Këtu pyetja na paraqitet në kuptim të një debati. Neve kemi të drejtë të paraqesim një pyetje të këtyllë - “Me të cilën Bibël ju jeni tani duke folur?” “Përse ekziston vetëm një Bibël” thotë krishteri duke murmuritur.

BIBLA KATOLIKE

Duke e mbajtur në dorë Versionin “Douay” të Biblës romano-katolike, unë pyeta: “A mund ta pranoni këtë Bibël si fjalë të Zotit”? Për arsye mirë të njohura për ta, Shoqata e Besimtarëve Katolikë, pat publikuar versionin e tyre të Biblës së shkurtuar, në një formë shkel shko. Ky version është pa lidhje në raport me proporcionet e shumta të versioneveqë janë në shitje. Me këtëpyetje i krishteri u bezdis, dhe tha “Për çfarë Bible është fjala?”, “Për arsye se menduat të thoni se ekziston VETËM NJË BIBËL”, ia përkujtova. Duke hezitur tha P-O-O, “por çfarë versioni është Ky”?E pyeta, “pse ky do të ishte diç tjetër”? Sigurisht që është, edhe predikuesit profesionistë këtë e dijnë. Vetëm mashtrojnë me fjalën “NJË BIBËL’ është.

Bibla romano-katolike është publikuar në Reims (Francë) më 1592nga vulgata Latine e Xhremuit, dhe është shtypur në Douay më 1609. Ky version romano-katolik (RCV) është Versioni më i vjetër, i cili sot mund të blehet. Edhe pse ky paraqet një antikuitet, e gjithë bota protestante, duke llogaritur edhe “Kultet”, dënojnë këtë version tp RCV, për arsye se ky përmban edhe shtatë “Libra” më shumë, të cilat i referohen “Apokrifëve” vullgarë siq p.sh. AUTORITETI I PLOTËDYSHIMTË. Aq më tepër, apokalipsa e çoroditur, që është libri i fundit i RCV, është shpallur si “Revelatë Protestante”. Ky titull i shëmtuar i është dhënë nga e fanatikëve të “Dëshmitarëve të Jehovës” dhe nga sekti “Dita e Shtatë e Adventistëve”, etj.

“... Nëse ndokush do t’i shtojë fjalë ose t’i heq prej Biblës, edhe Zoti atëherë nga ana e vete, do t’i mallkojë ato çka përmbajnë këto libra, (Revelata, 22:18-19).

Por kush çanë kokën për këtë! Në realitet, ata vetë këtyre nuk u besojnë! Protestantët me qëllim nga Libri i Zotit të tyre, i kanë përpiluar shtatë libra. Ato që nuk i kanë marrë në konsideratë janë:

- Libri i Xhudithit,
- Libri i Tobiasit,
- Libri i Baruhit,
- Libri i Estherit, etj.

BIBLA PROTESTANTE

Sir Vinston Çerçili e pat parë të arsyeshme të thotë diçka rreth Versionit të autorizuar (AV) të Biblës Protestante, e cila ishte e njohur si “Versioni i Mbretit Xhejms” (King James Version – KJV).

“Versioni i Autorizuar i Biblës është publikuar më 1611 me Dëshirë dhe urdhër të Madhërisë së tij Mbretit Xhejms, emrin e të cilit e mban deri në ditët e sotme”

Romano-katolikët besojnë edhe sot se protestantët e kanë sakotosur Librin e Zotit duke ia shtuar ose cunguar kuptimin, me çka kanë bërë “krimin protestant”, të kryer me forcë ndaj konvertitëve të tyre për t’i bindë që ta pranojnë Versionin e

Autorizuar (AV) të Biblës, e cila paraqet Biblën e vetme të botuar në afro 1500 gjuhë të popujve më të prapambetur të botës. Romano-katolikët i mjelin lopët e veta, por këto ua lënë t'i kullosin protestantët! Pjesa dërmuese e krishterëve-katolikë dhe protestantë e përdorin Versionin e Autorizuar (VA) të Mbretit Xhejms (KJV), ashtu si quhet alternativisht.

ADMIRIMET E ZJARRTA

Sikurse që pat thënë Sir Çerçill, publikimi i parë i këtij Versioni u bë më 1611, kurse revidimi më 1881 (RV), dhe tani më 1952 si i rireviduar Versioni Standard (RSV) dhe i cili prap u revidua më 1971, (Versioni i ri-ri-reviduar për një kohë të shkurtër). E tani të shohim se çfarë mendon Krishtërizmi për këtë Bibël më të reviduar, për (RSV):

“VERSIONI MË I MIRË I CILI KA MUND TË PËRPILOHET NË KËTË SHEKULL” (gazeta e kishës Anglikane) TRANSLITERIMINË TËRSI I FRESKËT, I PËRPILUAR NGA DIJETARËT MË EMINENTË (times, shtojca letrare).

VETTË SHUMË TË KËNDSHME TË VERSIONIT TË AUTORIZUAR TË KOMBINUARA ME NJË TRANSLITERIM TË PËRPIKTË (life and work).

VEPËR MË PËRPIKËT DHE MË E PËRSOSUR SE ORIGINALI (Times).

Njerëzit e shtëpisë botuese Kollins (Collins), në shënimet e tyre të paraqitura në fund të produksionit, për Bibël, në faqën 10 thonë: KJO BIBËL (RCV) ËSHTË VEPËR E 32 DIJETARËVE, TË NDIHMUAR NGA KOMISIONI MBIKËQYRES, TË CILIN E PËRBËJNË 50 BASHKËPUNTORË TË SHQUAR.

Çfarë është gjithë ky lavdërim? Me botimet e tyre ta përfitojmë masën e lehtëbesimtarëve? Të gjitha këto dëshmi ta bindin myshteriu (klientin) për përkrahjen e tyre që t'i hipë kalit të kërkuar, myshteriu i cili nuk dyshon se është i gatshëm për t'hipur kalit.

LIBRAT MË TË KËRKUARA NË BOTË

Çka të themi për Versionin e Autorizuar të Biblës (AV), për “Librin më të kërkuar në botë? Janë të gatshëm të thonë diçka rreth kësaj. Megjithatë, në faqën - - - në paragrafin gjashtë të HYRJES SË VERSIONIT (RSV) mund ta lexojmë edhe këtë: VERSIONI I MBRETTI XHEJMS (

PËRSHKRIMI ALTERNATIV I VERSIONIT TË AUTORIZUAR) ME AARSYE ËSHTË QUAJTUR SI MONUMENT MË I NDRITSHËM I PROZËS ANGLEZE. MË 1881, REVIDUESIT E TIJ JANË SHPREHUR ME ADMIRIN PËR THJESHTËSINË E BIBLËS, DINJITETIN DHE FUQINË E SAJ PËR PËRBËRJEN E SHKËLQYESHME ... PËR KADENCËN E MUZIKËS DHE RITMIN E SAJ TË KËNAQËSISË. NUK ËSHTË SI LIBRAT E TJERA QË

KANË ELEMENTE TË MBARËSTRUARA PERSONALE DHE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË POPUJVE ANGLISHTËFOLËS. ANDAJ, NDAJ KËTIJ LIBRI NDIEJMË RESPEKT TË VEQANTË.

I dashur lexues, a mund ta imagjinoni konsideratën “për madhështinë që i bëhet “Librit të Librave”, si që është cekur më lartë? Unë për veti, nuk mendoj kështu. I krishteri le t’i besojë, por tani ai shtanget nga sulmet e të gjithë atyre që i takojnë Mbrojtësve të religjionit: të cilët me një gojë theksojnë:

DERISA VERSIONI I MBRETTIT XHEJMS KA TË META TË HATASHME , DHE KËTO TË META JANË TË SHUMTA DHE SERIOZE, KËTO NA THËRRASIN QË TA BËJMË NJË REVIDIM NË TË ... “KY ËSHTË DREJTIMI QË VJEN NGA GOJA E KALIT” D.M.TH NGA DIJETARËT MË EMINENTË. NJË GRUP JETËR I DOKËTORËVE TË HYJNISË TANI KËRKOJNË TË HARTOHET NJË ENCIKLOPEDINË CILËN DO TË SHPJEGOHESHIN ARSYET E KËTYRE DEFEKTEVE TË RËNDA DHE SRIOZE, PËR T’I MËNJANUAR NGA LIBRI I SHENJTË I TYRE:

P A R A T H Ë N J E

VERSIONI REVIDUAR STANDARD I BIBLËS PARAQET NJË REVIDIM TË AUTORIZUAR TË VERSIONIT STANDARD AMERIKAN, I PUBLIKUAR MË 1901, I CILI ISHTE REVIDIM I VERSIONIT TË MBRETTIT XHEJMS

(KING JAMES), I VITIT 1611.

VERSIONI I PARË ANGLEZ I BIBLËS ËSHTË PËRPILUAR SI PËRKTHIM I DREJTËPËRDREJTË NGA ORIGINALI HEBRAIK DHE GREK, DHE BOTIMI I PARË I TIJ ËSHTË KRYER NGA VILJAM TINDEJL (VILIAM TYNDALE). PËR KËTË AI PATI KUNDËRSHTARË TË ASHPËR. ISHTE AKUZUAR SE KA BËRË PLOTË GABIME DHE PERVERSIONE NË TË KUPTUARIT E BIBLËS, DHE KËSHTU DHJATA E RE E TIJ U DOGJ SI “NJË PËRKTHIM I PAVËRTETË” ME URDHËRIN E AUTORITETEVE ADMINISTRATIVE. NË FUND U SHPALL SI TRADHËTAR DHE I RA NË DUAR TË ARMIQËVE, TË CILËT NË MUAJIN TETOR TË VITIT 1536. PUBLIKISHT E MBYTËN TË LIDHUR NË HU.

DERISA VEPRA E TINDEJLIT PARAQISTE BAZËN PËR NJË VERSION TË MËVONSHËM ANGLEZ, SIDOMOS AI I KOVERDAJLIT (COVERDALE), I VITIT 1535, I THOMAS METJUIT (THOMAS MATHEW), NDOSHTA PSEUDONIM I XHON ROXHERSIT (JON ROGERS), TË VITIT 1537, I BIBLËS SË MADHE TË VITIT 1539, I BIBLËS SË GJENEVËS TË VITIT 1560, BIBLËS SË IPESHKËVE TË VITIT 1568. PËRKTHIMI I DHJATËS SË RE I VITIT 1582 ËSHTË BËRË NGA VULGATA LATINE ROMANO-KATOLIKE, NGA ANA E PROFESINISTËVE DHE BOTIMI I SAJ U BË NË REIMS (FRANCË).

PËRKTHYESIT E VERSIONIT TË MBRETTIT XHEJMS I KANË MARRË PARASYSH TË GJITHA VERSIONET E PËRMENDURA, KU KRAHASON TREGON SE NGA TË GJITHA BIBLAT E PËRMENDURA ËSHTË MARRË NGA PAK PËR TA PËRPILUAR VERSIONIN E MBRETTIT, KY PËRMBAN FRAZA DHE SHPREHJE TË PËRSHTATURA PREJ SHUMË BURIMEVE, TË CILAT JANË PËRSHTATUR PËR MËNYRË TË PËRDORIMIT PUBLIK, PËR KËTË MË SË SHUMTI KA SHËRBYER DHJATA E RE E TINDEJLIT.

VERSIONI I MBRETTIT XHEJMS KA PASË PËR DETYRË TËI KONKURROJË BIBLËS GJENEVIANE NË PËRPUNIMIN POPULLARIZUES, MË NË FUND ËSHTË PARAPARË QË TË MOS KETË NDONJË PËRKTHIM TË AUTORIZUAR TË BIBLËS ANGLEZE PËR 250 VJET. VERSIONI I MBRETTIT XHEJMS ËSHTË PRANUAR SI “VERSIONI I AUTORIZUAR” PËR POPUJT ANGLISHTËFOLËS.

ME GJITHË MEND, VERSIONI I MBRETTIT XHEJMS, ËSHTË PRANUAR SI “MONUMENT MË I ÇMUAR I PROZËS ANGLEZE”. REDAKTORËT E TIJ TË VITIT 1881 KANË SHPREHUR ADMIRIM PËR THJSHTËSINË, DINJITETIN, FUQINË, PËR SHPREHJET E QËLLUARA ... MUZIKËN E KADENCËS, DHE PËR RITMIN MJESHTËRORË TË TIJ. SI NË NJË LIBËR TJTËR, NË TË KA ARDHUR NË SHPREHJE, KARAKTERI PERSONAL DHE I INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË POPUJVE

ANDLISHTËFOLËS. PRANDAJ NEVE JEMI
BORXHËLINJË TË PAMASË NDAJ KËSAJ.

POR VERSIONI I MBRETTIT XHEJMS ENDE KA TË
META TË MËDHA.NË GJYSMËN E SHEKULLIT XIX,
ZHVILLIMI I STUDIMEVE TË BIBLES DHE
DORËSHKRIMEVE MË TË VJETRA SE VERSIONI I
MBRETTIT XHEJMS. I CILI ËSHTË BAZUAR NË KËTO.
KANË TREGUAR SE KËTO DEFEKTE KANË QENË
MJAFT TË SHUMTA DHE SERIOZE SA QË ËSHTË
DASHUR TË BËHET REVIDIMI I VERSIONIT ANGLEZ.
KËTË DETYRË E KA MARRË MBI VETI KRYESIA E
KISHES ANGLIKANE, ME 1870. VERSIONI I REVIDUAR
ANGLEZ U BOTUA MË 1881-1885; KURSE MË 1901U
BOTUA VERSIONI STANDARD AMERIKAN, ME
NDRYSHIME TË PREFERUARA NGA ANA E
PROFESIONISTËVE TË INKUADRUAR NË KËTË PUNË.

DUKE PASUR NJË EKSPERIENCË TË HIDHUR ME
PUBLIKIME TË BIBLAVE TË AUTORIZUARA NË DY
DEKADAT NDËRMJET 1881 – 1901, NË TË CILAT ËSHTË
BËRË NJË PËRZIERJE E TEKSTEVE TË VERSIONIT TË
REVIDUAR ANGLEZ, ME QËLLIM TË PËRSHTATJES
PUBLIKUT AMERIKAN. U PËRPILUA VERSIONI I BIBLËS
STANDARDE AMERIKANE. PËR ARSYE TË MBROJTJES
SË TEKSTIT NGA NDRYSHIMET E PAAUTORIZUARA.
KY BOTIM U PRANUA MË 1928 NGA ANA E KËSHILLIT
NDËRKOMBËTAR PËR EDUKIMIN FETAR, DUKE U

BËRË PRONË E KISHAVE TË SHTETEVE TË BASHKUARA DHE KANADASË. TË CILAT ISHIN SHOQËRUAR NË KËTË KËSHILL ME ANËN E BORDEVE PËR EDUKIM DHE PUBLIKIME.

KËSHILLI KISHTE EMËRUAR NJË KOMITET TË PËRBËRË NGA DIJETARËT , TË CILËT ISHIN NGARKUAR ME HULUMTIME TË MËTUTJESHME TË TEKSTIT TË VERSIONIT STANDARDT AMERIKAN.

KAPTINA IV

PESËDHJETË MIJË GABIME (?)

“Dëshmitarët e Jehovahës” në magazinën e tyre “ZGJOHUNI”, i datës 8 shtator 1957, pat filluar me titullin kryesor: “50.000 gabime në Bibël?” (shiko faqen vijuese si është riprodhuar).

Derisa isha duke formuluar temën për këtë broshurë, të dielën në mëngjes dikush trokiti në derë. E hapa derën. Një zotëri evropian qëndronte aty duke i zgërdhirë dhëmbët. Më tha; “mirëmëngjesi”. Ia ktheva me “mirëmëngjesi”. Ma ofroi magazinën ‘Zgjohu’ (AWAKE) dhe “Kulla e Rojës” (WATCHTOWER). Po, e “Dëshmitarëve të Jehovahës”! Nëse jeni duke pritur ndonjë njeri që të trokasë në derë ai është i njohur për Ju, këtë e dini. Kjo ishte një trokitje e dikujt të pasjellshëm që të mund ta bënte. E thirra brenda.

Derisa ulej, unë në tërsi ia reproduktova tekstin e faqes 13. Duke ia cekur monografin.

ZGJOHUNI

“TANI ËSHTË KOHA PËR TU ZGJUAR”

- Romakët, 13:11

Në faqën e parë të gazetës, e pyeta “a është kjo e juaja”? Menjëherë e njohu vetveten në shkrim. I thashë: “do të thotë 50.000 gabime në Bibël,” a është kjo një gjë e vërtetë? M’u përgjigj:

Për çka është fjala? Unë ia përsërita: “Do të thotë se në Bibël gjenden 50.000 gabime’. Më pyeti se ku ikam gjetur këto. (Kjo ka qenë e publikuar para 23 viteve, ndoshta ky atëherë ka qenë foshnje). I thashë: T’a lëmë shakanë anash – a është kjo gjë e juaja”? duke ia treguar monografin “ZGJOHUNI”. Më pyeti se a mund ta shikijë“?

“Sigurisht” i thash dhe ia dhash faqen ku flitej për t’u zgjuar. Filloi ta shikojë me kujdes. Ata (Dëshmitarët e Jehoës) janë ushtruar në këtë mënyrë. Shkojnë pesë herë në javë në kësi lloji të shkollës, janë misionarë më të organizuar midis 1001 sekteve dhe propaguesve të botës krishtere. Janë të mësuar edhe në atë mënyrë që kur të gjenden në pozitë të keqe, nuk të lënë ta çelësh gojën. Prit pra Inspirimin e Shenjtë që të mëson ta thuash ndonjë fjalë!

Z G J O H U N I !

“është kohë e fundit për tu zgjuar” Romakët, 13:11

Bruklín, N.Y. 8 shtator 1957

KRISHTERËT PRANOJNË! “FJALA E JUAJ ËSHTË E VËRTETË” XHONI 17:17

50.000 GABIME NË BIBËL?

Para një kohe, një djalë i ri shiste Versionin e Biblës të Mbretit Xhejms (King James), duke menduar se ishte pa gabime. Një ditë kur i hodhi një sy faqës së mbrmë të magazinës Luk (LOOK), aty pa një artikull të titulluar “E vërteta Mbi Biblën”, për të cilën

thuhej se është e hershme, e vitit 1720. Një ekspert anglez mendonte se në atë Bibël ka më se 20.000 gabime, respektivisht në të dy edicionet e Dhjatës së Re” të cilën e përdorin protestantët dhe katolikët.

Studiusit bashkohorë mendojnë se aty gjenden ndoshta edhe “50.000 gabime”. Me të parë këtë, ky djalë u shtangua. Besimi i tij tani në autencitetin e Biblës ishte luhatur. Pyeste veten sesi mund të arsytohej bibla në të cilën gjenden me mijëra mospajtime dhe të pavërteta.”

Ashtu i qetë, e ndiqja me shikim se me çfarë shpejtësie e lexonte atë faqetë magazinës. Përnjëherë filloi të kërkojë diçka. Dhe, e gjeti. “Shpirti i Shenjtë” e xëgiti. Në artikull thuhej se shumë nga këto gabime ishin evituar”. E pyeta pasi që janë mënjanuar aq shumë gabime, a thua sa kanë mbetur prej 50.000 sosh. A mos 5000? 500? Apo ndoshta 50 kanë mbetur?

Edhe nëse kanë mbetur 50 gabime, a mos Zoti do t’ia atribuoni ato?” Nuk foli asgjë. Kërkoj ndjesë duke më thënë se një ditë tjetër do të vinte prapë me ndonjë anëtar më të vjetër të Kishës. Atë ditë duhet të mbaheni!

Kur ta kryej këtë broshurë do t’i bëja një ofertë, do t’i thosha: “Dëshiroj ta bëjë një të mirë, ma jepni emrin dhe adresën tuaj, si dhe numrin e telefonit. Dua që t’ju huazojë një broshurë “ A është Bibla fjalë e Zotit?” dhe të ma ktheni pas 90 ditësh. Nëse dëshironi do të përgjigjem. Këtë do ta bënte çdo musliman. Ata dhe misionarët e tyre kurrë nuk do t’ua trokisnim derën e juaj. Besoj se

ky publikim do të jetë më efektiv se çdo talisman (hajmali) Inshaallah.

“Kulti” i Dëshmitarëve të Jehovahës është shumë i rreptë në dënimin e Trinisë ortodokse për arsye të shtrejbërimeve të “Fjalës së Zotit” është duke luajtur më ‘Fjalët e Zotit’ e njëjta lojë me gjimnastikën semantike. Për artikullin e revistës “50.000 gabime në Bibël” ata thonë: “Ndoshta janë 50.000 gabime ... që janë përvjdhur në tekstin e Biblës ...” 50.000 gabime serioze (?) ... shumica të ashtuquajtura gabime ... pra, “Bibla në tërsi ndoshta është e saktë“ (!)

Neve nuk kemi kohë e as hapësirë që të thellohemi në dhjtmijëja defekte më të mëdha e të vogla për të cilat presin autorët e Versionit të Reviduar Standara (RSV) t’i revidojnë. Këtë privilegjë uan lëmë ekspertëve krishterë të Biblës. Këtu vetëm dua të vë në pah “një çik” të gabimeve “të vogla”.

“ Prandaj Zoti vetë do të jep shenjë: “Bëhu edhe ti virgjër, do të mbetesh shtatëzënë, dhe ty do të lindë një djalë, i cili do ta ketë emrin Imanuel (Emanuel) (Isai,7:14 – AV – Versioni Amerikan)

Kjo “Virgjër” që gjendet si gjë pashlyeshme nëversetin e përmendur, tani në RSV është ndryshuar me këto fjalë: “O grua e re”, gjë që është një përkthim korrekt nga fjala Almah, Almah është një shprehje e cila gjendet në të gjitha tekstet hebraike, e jo bethullah që do të thotë Virgjëreshë. Një korigjimë i tillë gjendet vetëm në përkthim të Biblës në gjuhën angleze, si që është përkthyer Bibla e RSV në kërk gjuhë. Për afrikanë dhe afrikanezë

arab dhe zullu, respektivisht në 1500 gjuhë të tjera, krishterët ende vazhdojnë me përkthimin e gabuar të fjalës “Virgjër”

I LINDUR NGA ZOTI E JO I KRIJUAR

1) “Jezui është bir i lindur nga Zoti e jo i krijuar; kjo është një shtesë në katekizmin ortodoks që ka për qëllim ta mbështet këtë thënjë:

2) Zoti, i cili aq e do këtë botë, për hir të saj e lind një djalë, kështu që ai beson këtij, nuk do të zhduket, dhe do ta ketë një jetë hyjnore. (Xhoni 3:16) (AV)

Asnjë prift nuk është i denjë të jetë bartës i petkut priftëror nëse në predikimin e ktishterëve prespektivë u thotë: “Bir i vetëm, të cilin e lindi Perëndia, është Jezui. Trajtimi i fjalës “I lindur nga Zoti” nga ana e revizionistëve të Biblës, është hequr bile edhe pa asnjë kërkim të ndjesës. Ata janë sjellur shumë të qetë në këtë kontekst si të ishin minjtë e kishës, i kanë larguar fjalët në mënyrë të fshehtë që të mos ia tërheqin vëmendjen lexuesit. “Shprehja e shtrembëruar ‘I lindur nga Zoti’ është futur në shumë tekste të “Biblës së shenjtë“. Sa më rëndë le t’ie mallkojë Zoti i Plotëfuqishëm këtë blasfemi (kufër), si dhe ata që e zbuluan! Që 2000 vite nuk doli asnjë njeri e njohësve të biblës që ta mënjanojnë këtë mashtrim.

DHE ATA THONË (ZOTI) MË I LAVDISHMI LINDI DJALË!

ME TË VËRTETË JU JENI ATA QË PO PËRHAPNI KËSO
GJËRA MONSTRUOZE!

NGA KËTO QIEJTË TANË GATI DIGJEN DHE, TOKA
TË COPËTOHET DHE MALET TË SHKATËRROHEN
DERI NË FUND.

NGASE ATA DO TË THIRREN NË BIRIN (ZOTIN) MË
TË LAVDISHËM PËR ATË SE KJO ËSHTË GJË E
PAPAJTIESHME NË MADHËRINË (ZOTIN) MË TË
LAVDISHËM SE AI DO TA LINDTE NJË DJALË

(Kur’ani i Shenjtë, 19: 88-92)

Bota myslimane do ta kishte përshëndetur takimin e “50
bashkëpunëtorëve klerikë krishterë” dhe udhëheqësinë e tyre të
përbërë nga 32 shkenctarë eminentë, të cilët janë duke u përpjekur
të bëjnë një afri me të vërtetën Kur’anore

ZOTI I PLTËFUQISHËM NUK LIND DHE, NUK ËSHTË
I LINDUR (KUR’ANI I SHENJTË, 112:3)

MATEMATIKA MESIANE KRISHTERE

3) Për atë, tri fuqi qëndrojnë në qiell: ati, Fjala dhe Shpirti i
Shenjtë, dhe që të trija janë një“ (Epistulli I i Xhonit 5:7 – AV).

Ky verset paraqet një shpjegim të përafërt të cilin krishterët e

quajnë Trinia e Shenjtë në enciklopedinë me emër Bibël. Ky gur themeltar i besimit krishter gjithashtu është hartuar nga RSV (Revised standard Cersion), pa pasur kurrfarë ngjajshmërie interpretimi me origjinalin. Më një përkushtim kinse të devotshëmrisë fetare, fund e krye është shtrembëruar kuptimi i drejtë i Biblës së RSV-së për popuj anglishtëfolës. por për 1499 grupe tjera gjuhësore të botës , të cilat i njohin këto ujdise krishtere në gjuhët amnore të tyre, këto falsifikime, prapseprap, mbesin. Këta njerëz, deri në Ditën e gjykimit kurr nuk do ta mësojnë të vërtetën. Megjithatë, myslimanët duhet prap ta përshëndesin Shoqatën e Mrekullueshme D.D. e cila ka pasur nderin t'i eliminojë gënjeshttratë e tjera nga Bibla Angleze (RSV), gjë që ka ndikuar që Libri i Shenjtë i tyre t'i afrohet më tepër predikimeve Islame. Ndaj, në Kur'anin e Shenjtë thuhet:

“DHE MOS THUAJ TRINI”

“BRAKTISENI KËTË, MË MIRË DO TË JATË PËR JU”!

“ANDAJ ALLAHU ËSHTË I VETMI ZOT”

(Kur'ani i Shenjtë, 4:171)

TË NGJITURIT NË QIELL

Një prej “të metave cilësore” janë ato të cilat autorët e RSV-së janë përpjekur t’i ndreqin përkitazi me të ngjiturit e Krishtit në Qiell. Për këtë dukuri kanë figuruar vetëm dy referenca në Ungjijt e Kanonit të Mateut, Markut, Lukës dhe të Xhonit, si ngjarje shumë të shtrembëruara në krishtërim-p.sh. Ngjtja e Jezuit në Qiell. Çdo Bibël i ka pranuar këto referenca në të gjitha gjuhët, e më e para ajo e RSV-së më 1952.

Aty thuhet:

4a. “Kështu, Zoti-Jezu pasi që atyre u foli, u ngjit në Qiell dhe u gjend në dorën e djathtë të zotit në Qiell”

(Marku, 16:19) 4b. “Pasiqë i bekoji ata, u nda prej tyre, dhe u ngjit lartë (Luka, 24:51)

Tani, ju lutem shikojeni faqen e 19 e cila është fotokopjim i asaj ku mbi numrin 4 është cituar kjo dukuri. Do të hutoheni me atë kur se shënimi i fundit 16, i versetit 8 të Markut, pas një paraqitjeje të gjerë në sipërfaqen e bardhë, versetet e shtrembëruara janë shtypur me germa “petit” sikurse të ishin shënime të fusnotave që vëhen në fund të faqes. Nëse e shikoni me vëmendje Biblën e RSV-së të vitit 1952, do t’i shihni gjashtë fjalët e fundit të shënimit 4b, të cilat figurojnë më lartë: “Dhe Ungjijtë lartë në Qiell” të shndërruar me një “a” gati të padukshme, e cila ju shtynë ta shikoni fusnotën ku gjenden këto fjalë të shtrembëruara. Secili krishterë i ndershëm duhet ta shikojë fusnotën ku gjenden këto fjalë të shtrembëruara. Secili krishterë i ndershëm duhet ta pranojë

faktin se fusnotat në çdo Bibël nuk paraqesin fjalët fjalët e Zotit. Përse besimtarët e devotshëm krishterë duhet t'i nënshtrohen të pavërtetës kur këtu kemi të bëjmë me një mrekulli të jashtëzakonshme të fesë së tyre, dhe këto t'i shënojnë me fusnota të pavlefshme.

Nga Karta - ORIGJINA DHE ZMADHIMI I BIBLËS ANGLEZE, e cila shfaqet në faqen 26, mund ta dalloni faktin se të gjitha Versionet Biblike kanë qenë a priori të Versionit të Reviduar të vitit 1881, dhe ato janë përpiluar në bazë të KOPJEVE TË VJETRA, 500 apo 600 vjet pas Jezuit. Reviduesit e RSV-së të vitit 1952, kanë qenë njohësit e parë të cilët ishin të aftë t'i shfytëzojnë pjesët më të vjetra – Kopjet e Vjetra të shekullit 300 apo 400 pas Krishti. Pajtohem me faktin se si dokumente kanë qenë më të afërta si kopje burimore. Natyrisht, pjesa më e madhe e besimtarëve të drejtë ishin më të denjë se ata MË TË VJETRIT. Në asnjë vend nuk mund të haset fakti se është përmendur “se Jezui është ngritur në Qiej”, kjo sidomos nuk gjendet në DORËSHKRIMET E VJETRA, dhe këto terma priftët krishterë i kanë hequr nga përdorimi prej Biblës së RSV-së e vitit 1952. Mark 16

NJË CIRK ME GOMAR

Faktet e lartpërmendura paraqesin një besim të paqëndrueshëm të botës krishtere nga shkaku se autorët e inspiruar të ungjijve Kanonik i kanë harruar të gjitha faktet dhe fjalët rreth “Ngritjes në Qiell të Jezuit” Këta autorë të “inspiruar” që të gjithë, janë të “inspiruar” me mendime kur u përkujtohej “Zoti” dhe “Shpëtimtari” i tyre, i hipur në gomar, pas predikimit, qysh është duke hyrë në Jeruzalem.

A thua se Zoti i Plotëfuqishëm do të ishte autor i këtyre fjalëve të papëlqyeshme; kur braktiset rruga e Tj shihet nga këto fakte kur të gjithën përpiluesit e Ungjijve nuk harrojnë ta fusin në tekst atë që u përkujtonin “Birin e Zotit” dhe shpëtimtarin e tyre duke qenë i hipur mbi gomar, hynë në Qytetin e Shenjtë - dhe ende janë “duke u inspiruar” me mjegullimin e të dhënave rreth fluturimit të “Birit të Shenjtë” në krahët e engjëjve (?)

JO PËRGJITHMONË

Evangelistët e flakët dhe biblistët e zhurshëm nuk kanë qenë aq vigjilentë për të parë këtë lojë aq të dyshimtë. Me kohë kanë qenë mundësuar ta mënjanojnë gurin themeltar tëpredikimeve mbi “Ngritjen e Jezuit në Qiell”- e kjo ka qenë minim i erudicionit mbi Biblat Krishtere, prej ku publicistët e RSV-së kanë realizuar një net profit prej 15 mil. dollarësh. (pesëmbëdhjetë mil). Propagandistët kanë bërë një poterë të madhe për t’i formuar dy grupe njerëzish nga 50 veta, të cilët i kanë detyruar publicistët që t’i inkorporojnë

në tekste të Biblës “Fjalët inspiruese të Hyut”. Pas vitit 1952, në çdo publikim të RSV-së janë kthyer tekstet të cilat më parë janë hudhur.

Në vizatimet e sipërme shihet zhvillimi gradual i Biblës Angleze sikurse edhe themelimit i çdo versionit të ardhshëm.

Neve jetojmë brenda një periudhe të botimit, është shumë e vështirë për neve ta realizojmë saktësinë se në atë kohë kur kanë qenë Biblat origjinale të shkruara nuk ka pasur mundësi të shumëfishohen, për arsye se atëherë nuk ka pasur shtypshkronja.

Çdo kopje që bëhet duhet të përcillet me kujdes dhe të shkruhet me dorë. Në kushte të tilla ka qenë e pamundur që të mos humben dorëshkrimet e vjetra. Pasqyra e sipërme na tregon faktin se të gjitha dorëshkrimet origjinale janë tretur.

Shtrohet pyetja ku e kemi literaturën themeltare të Biblës sonë?

1) Tani kemi kopjet më të vjetra të dorëshkrimeve origjinale. Këta mendojnë për tri mundësi:

a) Kodeksi i Sinanit (Codex Sinaiticus), i Biblës greke i shekullit të IV, i blerë nga Republika e Sovjetike e Rusisë më 1933 nga ana e Britanisë së Madhe, i cili tani gjendejt në Muzeun Britanik (British museum)

b) kodeksi i Aleksandrisë (Codex Alexandrinus), ndoshta i shkruar në shek. E Y-të, edhe ky gjendet në Muzeumin Britanik. Ky përmban të gjitha Biblat greke me përjashtim të 50 fletëve.

c) Kodeksi i Vatikanit (Codex Vaticanus), në bibliotekën e

Vatikanit, origjinali i të cilit përbente Biblën në tërësi, pos disa pjesëve, është shkruar diku në shekullin e IV-të.

Këtu është fjala për një lojë të moçme. Hebrenjtë dhe krishterët e kanë pas botuar librin e tyre “Libri i Zotit” qysh prej fillimit. Dallimi në mes tyre dhe falsifikuesve të hershëm qëndron në faktin se këta të fundit nuk e kanë njohur “artin” për t’i përpiluar parathëniet “dhe fusnotat”, përndryshe, ata do ta thonin këtë mënyrë të qartë për falsifikimet e heronjve tanë modern, dhe për arsyet elokumente të tyre që kanë falsifikuar monetën e tyre të rrejshme duke u përpjekur ta bëjnë ar.

“Shumë propozime janë bërë për modifikimet që i janë nënshtruar Komitetit dhe individëve, e sidomos dy komiteteve Kishtare. Për të gjitha këto është DHËNË NJË KUJDES i madh nga ana e Komitetit”.

“Nga ana e Markut (16:9-20) dhe Lukës (24:51) dy pasazhe dhe pjesa e gjatë e fundit janë “restauruar” dhe si të tilla janë futur në tekst “Parathënie – faqet VI dhe VII të Kolinisit (Shtëpia Botuese Collings).

“Por pse të ripërtrihen?” për arsye se ato janë hjekur qysh heret nga Bibla. Pse autorët e “Ngritjes së Jezuit në Qiell” e kanë hequr këtë nga teksti? “Në dorëshkrimet më të vjetra” fare nuk përmendet Ngritja e Krishtit në Qiell. Ajo është futur nga Xhoni (5:7) kur flet për Trininë. Pse të largohet njëra e të përtërihet tjetra? Mos u befasoni! Me kohë Ju do ta çoni dorë nga RSV + komiteti, kur shihni se si kanë mundur të vendosin të heqin pjesën e

“Parathënës së pavlefshme”. “Dëshmitarët e Jehovahës” tashmë i kanë eliminuar 27 faqe të shpallura nga “Parathënia”, tani për t’i shënuar këto si “Përkthimi I RI Botëror i Biblës Krishtere Greke” (kjo është formë për t’ia quajtur këtë si Dhjata e Re)!

Reverendi (Hirësia) C.J Scofield (Skofild), D.D. me një grup të përbërë nga 8 botuesë, sikur të gjithë nga D.D në “Referencën për Biblën e Skofildit”, janë munduar përafërsisht të përcaktojnë fjalën hebraike “Elah”. Krishterët menjëherë kanë qenë të detyruar që prapseprap në fund të pranojnë se emri Zot e ka kuptimin Allah – por të shënuar me një -L- (Lord) të parëndomtë. (reprodukimi fotografik i Biblës në faqen më poshtë) tregon për fjalën Allah. Referncat e bëra për lexues nga ana e këtij autori, qartë na trgojnë për këtë fakt. Më besoni se “Scofield reference Bible” (Bibla sipas Skofildit) ka mbetur kuptim i tërë për komentimin e “Genesis” (Gjenesëz) (1:1), por në mënyr mjshtërore në te është eliminuar fjala Allah. Është e pamundur, që në të bile njëherë të mos përdoret fjala “Allah”. E njëjtë është edhe Bibla Ortodokse. Njeriu me të vërtetë është detyruar që në këtë rast të bëhet zhongler.

THE FIRST BOOK OF MOSES

Kaptina e V

BESIMI I MALLKUAR

Z. Elen G. Vajt (Ellen G. White), profetët e Kishës Adventistë” Dita e shtatë (Seventh Day) në komentimin e saj biblik, Vëllimi 1, faqe 14, pranon se janë bërë gabime nënë “Biblën e Sh4enjtë” Bibla, të cilën neve sot po e lexojm, është vepër e kopjuesve të shumtë, të cilët në raste të shpeshta, kanë kontribuar me punë të shkëlqyeshme në saktësinë e Biblës, por duhet pranuar se kopjuesit nuk kanë qenë të pagabueshëm, dhe sigurisht Zoti me rastin e transkribimit pa tjetër u ka falë gabimet dhe i ka mbrojtur nga maqllkimi. “Në faqen që pason në komentimin e Z. White, dëshmon edhe për këtë: “E di që Zoti Vetë duhet ta mbrojë Biblën” (prej kujt?)”Atëherë kur kishte pak kopje të saj, njeriu i shkolluar ndoshta në ndonjë rast i ka ndryshuar fjalët, duke u menduar që ta bën të kuptueshme, në realitet kur bëheshin mistifikime të shumta të pamira nga shkakut i mbështetjes në pikëpamjet e pararimeve të tyre, me të cilat është udhëhequr tradicionalisht”.

SËMUNDJE E PËRHAPUR

Sëmundja mentale kultivohet në njeriun. Kjo autore dhe ithtarët e saj trumpetojnë prej së larti se “Me të vërtetë Bibla është pa tjetër, Fjalë e Zotit”; adulte, por e pastër. Është e njeriut, por Hyjnore. Në gjuhën e tyre a kanë fjalët fare kutim? Po, për në

gjyqet e tyre, por jo në teologji të tyre. Në predikimet e tyre “kanë liçencë poetike;

NË ZEMRAT E TYRE QËNDRON SËMUNDJA DHE ALLAHU U KA SHTUAR ATYRE SËMUNDJEN DHE DËNIMI (QË DO TI GJEJË) ËSHTË I TMERRSHËM PËR ARSYE SE JANË GËNJESHTARË DËSHMITARËT

Zhurmaxhinjtë më të spikatur nga biblistat e flaktë janë “Dëshmitarët e Jehovës”. Në faqen 5 të HYRJËS në BIBËL të tyre, më herët ata rrëfeshin në këtë mënyrë.

DUKE I KOPJUAR ORIGJINALET E INSPIRUARA KA DEPËRTUAR, PA MËDYSHJE, EDHE DOBËSIA E NJERIUT, DHE ASNJË KOPJE PREJ MIJA KOPJEVE, NUK EKZISTON NË GJUHËN ORIGJINALE; ATO PARAQESIN DUPLIKATE TË PËRSOSURA. SI REZULTAT I KËSAJ GJENDJEJE ËSHTË FAKTI SE NUK GJENDEN AS DY KOPJE TË NJEJTA. Tani mund të shihet se e gjithë “hyrja” që i ka 27 faqe, është eliminuar nga Bibla e tyre. Allahu e ka shkruar që ata do ta varin veten me diturinë e tyre.

NË SOFËR (TAVOLINË) ÇKA KA QËLLUAR

Edhe pse manipulohet me 4000 kopje të ndryshme të dorëshkrimeve me të cilat krishterët lavdërohen, prelatët krishterë janë përcaktuar për katër prej tyre, të cilat janë përplotë me paragjykime, dhe këto i kanë quajtur Biblat e Mateut, markut, Lukës dhe Xhonit. Neve do ta përcaktojmë vendin e secilit prej tyre. Tani, t'ia hedhim një sy përmbledhjeve të hulumtimeve të “Dëshimtarëve të Jehovës” ashtu qysh janë shënuar në parafjalën r shkurtër: MEGJITHATE, ËSHTË EVIDENTE SE TEKSTI ORIGINAL I BIBLËS KRISHTERE ËSHTË PËRZIER ME QËLLIM, ME TË NJËJTIN TEKST LXX (shtatëdhjetë)¹²

Tani ky kult i pakorrigjuar ka pasur guxim dhe paturpësi që 9 mil. kopje (nëntë milion) t'i botojë si Edicion i Parë prej 192 faqesh me titull “A është Bibla në realitet Fjalë e Zotit?” Në të haset një mentalitet i sëmurë për shkak të shtrembëimeve të mëdha dhe të panumërta, sikurse përndryshe, që ata edhe thonë: AFEKTET E ÇMUARA NË AUTENCITETIN E BIBLËS (?). Kjo është logjika krishtere.

¹² Dhjata e Re

NJË DËGJIM ME DURIM

Dr. Graham Scroggie (G. Skrogi), në librin e tij më parë të përmendur, në faqen 29, për Biblën sqaron këtë:

LE TË JETËMË OBJEKTIVË SE QYSH E GJYKOJMË RASTIN (A është Bibla fjalë e Zotit?) KUR KEMI NDËRMEND ATË SE ÇKA JEMI DUKE DËGJUAR PO BIBLA ÇKA DO TË THOTË PËR VETI? P. sh. NË GJYQ KËRKOHEJ PREJ DËSHMITARIT QË TA THOTË TË VËRTETËN, DHE ATË QË E DEKLARON DUHET TA PRANOJMË, MEGJITHËSE JEMI NË POZITË QË TË DYSHOJMË OSE KEMI PROVA SE ËSHTË FJALA PËR NJË RRENACAK. KËSHTU EDHE BIBLËS DUHET T'IA JAPIM RASTIN PËR TA NDËGJUAR, DHE KËTË DUHET TA PRANOJMË SIKURSE KUR FLITET PËR NJË DËGJIM ME DURIM.

Dëshira është më vend dhe e arsyeshme. Do të bëjmë në mënyrë qysh vetë Bibla flet për veten.

Nëse pesë librat e para të biblës – GENESIS (Krijimi i botës). EXODUS (Dalja), LEVITICUS (Livitikët). numbers (NUKRAT) DHE DEUTERONOMY (Fjalë porositëse) ka më se 700 kallëzime të cilat janë prova të sakta se Zoti nuk është autor i këtyre librave, bile edhe Mozesi (Musai) këtu nuk ka dorë. Hapni këto libra dhe aty rëndom do të shihni:

- Dhe, Zoti i tha: Shko e sjell ata këtu poshtë ...
- Dhe, Musai i tha Zotit: Njerëzit nuk mund të vijnë ...

- Dhe, Zoti i foli Musait, duke i thënë ...
- Dhe Zoti i tha Musait: Zbrit poshtë dhe qortoi ata! ...

Kjo është plotësisht e qartë se këto nuk ishin fjalët e Zotit, e as të musait. Këto tregojnë se zëri injë personi të tretë, i cili shkruan sipas asaj çfarë ka dëgjuar.

MUSAI (MOZESI) SHKRUAN NEKROLOGUN E VET

A ka pasur mundësi që Musai t'a shkruan nekrologun e vet pas vdekjes? A nuk i kanë shkruar hebrenjtë nekrologjitë e veta? Kështu Musai ... VDIQ ...Dhe Zoti (i Plotëfuqishëm) e varrosi (Musain) ... kur vdiq i pat 120 vjet ... Dhe askush nuk u bë profet derisa Musai ishte në Izrael; (34:5-10). Ne do ta analizojmë pjesën tjetër të Dhjatës së Vjetër nga këndvështrimi tjetër.

Kaptina e VI

LIBRI I PAGËZUAR “DHJATA E RE”

Pse “SIPAS”?

Për çfarë arsye është quajtur “Dhjata e Re□”? Përse secila bibël fillon me pjesën hyrëse sipas ... SIPAS, (Shiko faqen vijuese) Përse “SIPAS?” Për arsye se në katërmijë kopjet që sot egzistojnë asnjëra nuk e ka autografinë (nënshkrimin) e autorit. Largone pra supozimin “sipas”Bile me provat e evidencës interiore është vërtetuar se Mateu nuk ka qenë autor i Biblës se parë e cila mbanë emrin e tij.

Dhe kur Jezui kaloi këtej, Ai (Jezui) pa një njeri, të quajtur Mate (Matthew) i ulur si zakonisht: dhe Ai (Jezui) i tha Atij (Mateut), ndiqëm Mua (Jezuin) dhe Ai (Mateu) u ngrit dhe e përcolli Ate (Jezuin). “(Mateu 9:9)”

□ i quajtur kështu për arsye se “Dhjata e Re” në asnjë vend nuk quhet me këtë emër si dhe “Dhjata e Vjetër”. Po kështu edhe fjala “Bible” është e panjohur në faqet e Biblës Zoti paska harruar ta emërojë “Librin e Vet”!

Pa kurrfarë imagjinate, njeriu mund të shoh se AI ËSHTË dhe I TIJ i tregimit të lartpërmendur, nuk i referohet as Jezuit e as Mateut si autorë të tij, por dikush i treti i shkroi atë që pa apo dëgjoi – hesap thashethemesh. Nëse ne nuk jemi në gjendje ta përcaktojmë faktin e këtij “Libri të ëndërrimeve” (ashtu si është përshkruar Bibla) që është vepër e mateut si mund ta pranojmë

këtë si Fjalë të Zotit? Ne nuk jemi të vetmit që e kemi zbuluar se Mateu nuk e ka shkruar “Bibla sipas Mateut” dhe kjo është shkruajtur nga ndonjë dorë anonime. J. B. Phillips (Gj. B. Filips) pajtohet me mendimet tona. Ai është besimtar i devotshëm i Kishës Anglikane, kanonik i Katedralës Çiçester në Angli. Besoj se nuk ka kuptim të gënjejë ose të bëjë ndonjë tradhti që ta gënjejë kishën e vet. Në lidhje me parathënjen e tij në “Biblën e Shën Mateut (këtu është reprodukuar në faqen vijuese), në të cilën filips flet për autorësinë e Biblës së Shën Mateut.

“Në traditën e hershme thuhet se kjo Bibël është e Aposulit Mate, por mendimtarët aktualë e hedhin këtë mendim në tërësi”. Me fjalë të tjera, mateu nuk është autor i Biblës e cila mban emrin e tij. Këtë e zbuluan studiuesit krishterë me famë të lartë, e jo hindusët, myslimanët ose hebrenjtë të cilët mund të akuzohen si kundërshtarë. Le të vazhdojë miku ynë anglikan: “Autori të cilin ne ende shumë të përshtatshëm mund ta quajmë Mate. “Konvenueshëm për arsye se sa herë duhet të përmendim ate (Maten) ne duhet të themi “Linri i parë i Dhjatës së Re” kjo kaptinë, ky verset e kështu me rradhë. Dhe sipas J. B. Phillips neve na KONVENON që librin ta emrojmëdisi e pse jo p. sh. “Mate”.Po supozojmë se ky si emër është mjaft i mirë si edhe emrat e tjerë1 Filipsi vazhdon: “Autori në tërësi ka rënë në - Q2 – misterioze e cila mund të jetë një kolekcion i traditës gojore.

Çfarë është kjo “Q” misterioze. “Q” është shkurtesë e fjalës gjermane “quelle” që do të thotë “burim”. Mund të supozohet se ndoshta është fjala për ndonjë dokument tjetër “burim i

përbashkët” – të cilin e ka njohur Mateu, Marku dhe luka. Që të tre këta autorë, pa marrë parasysh se cilët kanë qenë, kanë pasur të njëjtën konsideratë për materialin e shfrytëzuar. Ata kanë shkruar si të ishte “me sy” të njëjtë. Dhe për arsye se ata i kanë njohur shumë mirë tri ‘Biblat’ e para të njohura më vonë si “Biblat Sinoptike”

“PSE SIPAS”

BIBLA SIPAS SHËN MATEUT

Shën Mateu 9

Mateu thirrte

9) Dhe Jezui kaloi këtej,
dhe e pa një njeri me emrin
Mate, i ulur si zakonisht.

Dhe Ky i tha atij: ndiqëm!
dhe ky u ngrit dhe e ndoqi:
“AI” dhe “ATIJ” nuk është
Mateu.

23 Dhe AI kur e pa shënimin
e vjetër, dhe ky, shënim është
i vërtetë, e diti se ai po e flet të
vërtetën, të cilës ju duhet
besuar.

SHËN XHONI 21

24 Ky është nxënësi i cili,
dëshmon për këto gjëra që
janë të shkruara: dhe neve
e dimë se kjo dëshmi është
e vërtetë.

BIBLA SIPAS SHËN XHONIT

“AI” dhe “ATIJ” nuk është Xhoni!
Shën Xhoni 19.

KONKLUZA

25 Poashtu ka shumë gjëra që i ka bërë jezui, të cilat po të ishin
shkruar e gjithë bota vet nuk kishte për t’i zënë. Amen

Bibla sipas Shën lukës

1) Aq më tepër shumë vetë kanë pasë në dorë te deklarohen për këto gjera, të cilave sigurisht njerëzit në mes nesh u kanë besuar.

2) Kur na janë dhënë këto neve, që nga fillimi ishin të dëshmuara me sy dhe të vërtetuara me fjalë.

3) Unë poashtu, mirëfilli i kam kuptuar këto gjëra, prej së pari Teofil (Theophilus) i shkëlqyer ti i ke shkruar.

4) Ti je njohës më i mirë i origjinalitetit të këtyre gjërave, të cilat i ke mësuar. BIBLA SIPAS SHËN MARKUT?

BIBLAT E PËRKRYERA NË ANGLISHTËN MODERNE NGA J. B. PHILLIPS

BIBLA E MATEUT

“MËSUEI I MËSON NXËNËSIT QË TË MOS VJEDHIN,
POR KËTU MATEU I KA VJEDHUR TË GJITHA NGA
MARKU?”

Në traditën e vjetër kjo Bibël i është atribuuar apostullit Mate,
por sot dijetarët i kundërshtojnë pothuaj të gjitha këto pikëpamje.

Autori, të cilin ende konvencionalisht mund ta quajmë mate, ka
rënë në “Q” misterioze, e cila mund të jetë koleksion i traditave
gojore. Ai lirisht e ka përdorë biblën e Markut, edhe pse ai i ka
rënditur ngjarjet dhe shumë shpesh ka përdorur fjalë të
ndryshme të cilat faktikisht kanë të njëjtin kuptim. Stili është
lucid, i qetë dhe “i zbukuruar”. Mateu shkruan me një stil, në
njëfarë mënyre të pakuptueshëm, ashtu si që ka ditur ta përpunoj
materialin me kujdes, i bindur jo vetëm për të vërtetën e saj por
edhe se është si mostër hyjnore e përqendruar në faktet historike.

Sikur Mateu të kishte shkruar ashtu si supozohet diku rreth 85
dhe 90% atëherë vlera e kësaj bible si dokument Krishter kishte
me qenë shumë e madhe! Thënë kështu kjo vepër do të jetë
pikëpamje e gjeneratës së dytë të Jezu Krishtit, Djalit të Zotit dhe
Djalit të Njeriut. Duke qenë shkruar në një distancë të gjatë kohore
prej revalacionit, ku refleksionet e vetëdijës dhe bindja e fortë
ndoshta kanë ushtruar ndikim në balansim më të mirë të
portretimit TË REVELACIONIT të mrekullueshëm të Zotit, që

mund t’u ipet atyre që kanë qenë të dashurit e Dritës Hyjnore nga e cila bile edhe janë friguar.

LONDËR XHOFRI BLES (GEOFFREY BLES) PLAGJIATURË ME SHUMICË

Por ç’u bë me biznesin “INSPIRIMI”? Kanoniku anglikan me plotë meritë ia ka qëlluar. Ai është i thirrur për këtë punë. Shërbyesi i devotshëm i kishës, një fanatik i Kishës Evangjeliste, njohës me reputacion i Biblës, duke e njohur shumë mirë origjinalin e Dorëshkrimit Grek, le të na e shpalon këtë: “Ai (Mateu) lirisht e ka përdorur “Biblëne Markut”, gjë e cila në gjuhën e mësuesit të shkollës quhet të gjitha i ka kopjuar nga Marku” tani le të thonë krishterët për këtë plagjiaturë të tërë se është Fjalë e Zotit?

A nuk iu çuditë se një dëshmitarë me sy dhe vesh i priftërisë së Jezus, që është Mate, në vend që të shkruaj përshtypjet e tij të para të shërbimit të Zotit të tij, ai i vodhi ato nga marku i cili ishte 10 vjeçar kur jezu e qortonte popullin e vet. Përse një dëshmitarë që ka parë dhe dëgjuar krishtin i kopjon shënimet e shokut të vet i cili ka shkruar për veti, atë që ka parë dhe dëgjuar? Nxënësi mate nuk duhej ta bënte një gjë aq të marrë. Një dokument anonim i është atribuuar emrit të Mateut.

PLAGJIATURË A VJEDHJE LETRARE

Plagjiaturë quhet një vjedhje letrare. Dikush fjalë për fjalë i kopjon shkrimet e dikujt dhe i paraqet si të vetat, andaj kjo quhet plagjiaturë. Kjo është një veti e përbashkët e 40 autorëve të panjohur të librave biblike. Krishterët lavdërohen për këtë lidhje e cila ekziston midis shkruesve të 66 librave protestante dhe shkruesve të 73 librave romano-katolikë, të cilat ndryshe quhen “Bibla e Shenjtë”¹³ Një lidhje e ngushtë egziston në mes Mateut dhe lukës, apo kushdo tjetër që është, se ata kanë kopjuar 85%, fjalë për fjalë nga Marku. Zoti i Gjthëfuqishëm, sigurisht që nuk e ka bërë diktimin e fjalëve të njëjta sinoptistëve (shkruesve të Librave të Shenjta). Krishterët këtë vetë e pranojnë ngase nuk i besojnë inspirimeve verbale, sikurse që praktikojnë muslimanët kur është në pyetje Kur’ani i Shenjtë.

Kjo plagjiaturë e Mateut dhe Lukës¹⁴ duket e zvenitur ndaj autorëve të Dhjatës së Vjetër që kanë vjedhur 100% nga i ashtuquajturi Libri i Zotit. Dijetarët krishterë si p. sh. i kalibrit të peshkopit Kenet Krag (Keneth Cragg), i cili në formë eufemistike duke u lavdëruar, këtë vjedhje e quan reprodukim!

¹³ Llogaritni për ju tekstin e “Kur’anit”-Mrekullia e fundit” ku gjenden provat matematikë që dëshmojnë se Kur’ani fjalë për fjalë, gërmë për gërmë, është revelatë e allahut të Gjithfuqiahëm.

¹⁴ “A është Bibla fjalë e Zotit”? Moody Prees

STANDARDET E SHTREMBËRUARA

Dr. Skrogi (referuar më parë) me një entuziazëm të madh e lavdëron Jozef Parkerin (Jozeph Parker) në librin e tij, për veprën e tij unike të Biblës.

Çfarë libri është Bibla kurështë aq e pasur me përbërje të meterjes së bollshme! ... ku të gjitha faqet kanë absorbuar emra të panjohura, ku është folur shumë për gjenealogjinë e njerëzve deri në Ditën e Gjykimit. Këtu pak JANË PËRMENDUR NGJARJET që do të thotë se ngjarjet janë të gjymta dhe nata bie para se ne të tregojmë se ku gjendet fitorja.. ku janë gjërat e literaturës fetare të botës “të korespondohet mirë” në Bibël. Padyshim kjo duket si një gjerdan i bukur i fjalëve dhe frazave! Shumë zhurmë për asgjësend, një varg blasfemie (kufër) kundër Zotit të gjithëfuqishëm, për të na shyer ta përqafojmë një mishmash të fjalëve të tilla. Pra krishterët me sherr lavdërohen me defektet e librave të tyre, sikurse që lavdërohej Romeo me lythin në buzën e Xhulijetës!

HIQ MË PAK SE 100%

Për demonstrimin e shkallës së plagijaturës këtu të praktikuar nga ana e shkruarit të “inspiruar” të Biblës, i pata pyetur pjesëmarrësit e Simpoziumit të Univerzitetit të Kejptaunit, i udhëhequr nga unë dhe profesor Cumsty (Kampsti) shef i departamentit të teologjisë, mbi temën “A është Bibla Fjalë e Zotit”, dhe me këtë rast ai i hapi Biblat e veta.

Kur zhvillohen debatet dhe diskutimet, disa krishterë të

devotshëm ndaj Binlave të tyre, me ëndje ato i bartin nën sqetull. Pa këto libra duken sive janë dei në fund të paaftë për diskutim.

Me kërkesën time disa të pranishëm filluan t'i shpalojmë faqet e Biblës. Prej këtu kërkoja që ta hapnin kaptinën e 37 të "LIBRIT TË ISAIAHUT". KUR U BËN GATI, KËRKOVA TA KRAHASOJNË "Isaiahun37" të tyre me tekstin tim isaiiah 37, për të konstatuar se a janë identikë. Unë ngadalë, i lexova versetet 1, 2, 4, 10, 15 e kështu me rradhë deri në fund të kaptinës. pas leximit të secilit verset i pyetnja se a po përputhen versetet e mia me ato të tyre. Ata njëzëri në kor pohuan se "PO", "PO"! mia, prej atij vendi ku isha i ulur ia bëra me dije Kryesuesit që t'i tregojë publikut se ajo që unë lexova nuk ishte prej Isaiahut 37, por prej Librit II të "Mbretërve", 19, (2 Kings, 19). Me të dëgjuar këtë shikuesit tmerrësisht u hutuan. Atyre iu vërtetova faktin e gjallë se këto janë të plagjiatura të 100% që gjenden në "Biblën e Shenjtë" (shiko faksimilin në anglisht në faqen 44).

Me fjalë tjera Isaiah 37 dhe kings 19 ishin identike në mes veti fjalë për fjalë. Këto libra u atribuohen dy autorëve të shekujve të ndryshëm për të cilët krishterët mendojnë se atëherë ata janë "inspiruar" nga Zoti.

Shtrohet pyetja: kush kë e ka kopjuar? Cili po vjedh prej tjetrit? 32 dijetarë të shquar të Biblës RSV (revised standard Version) thonë se autori i "Librit të Mbretërve" është i "panjohur" (Shiko faqen e reproduktuar RSV-s nga Shtëpia Botuese "Collins" (Kollins). Kjo është theksuar në Biblën e përgatitur dhe botuar nga

Reverendi (hirësia) david (Dejvid) J. Fant. Litt.; D., sekretar i përgjithshëm i Shoqatës biblistike të Njujorkut. Natyrisht se hirësia e Zotërinjve të Kishës Krishtere nuk dyshojnë aspak në ate se Bibla është Fjalë e Zotit. Ata do ta kishin pranuar këtë mburrje (në mënyrë të turpshme dhe rrëfejnë se “Autori i Panjohur”. Ata janë të përgatitur që me devotshmëri t’i shërbejnë Biblave, të cilat do të shkruheshin nga ndonjë Tom, Dik apo Hari, duke pritur nga secili që këtë t’i konsiderojë si “Fjalë të Zotit” – Zoti na ruajttë.

ASNJË INSPIRIM VERBAL

Për regjistrim komplet të Biblave dhe autorëve të tyre, vlerësoje ate të “Collins” (Kollins) RSV, me shënimet e saja. Çfarë kanë krishterët për të thënë për “Librin e Isaiahut”? Ata thonë: “Kryesisht i besohet Isaiahut. Pjesërisht mund të jetë shkruar nga të tjerët”. Duke marrë parasysh pranimin e dijetarëve të Biblës ne nuk do ta shqyrtonim ate. (Isaiahun). Pra, a mundemi ne që këtë plagjiaturë t’ia veshim Zotit? Çfarë blasfemie! Profesori Cumpsty (Kampsti) në fund të Simpoziumit të lartpërmendur, pranon se: “Krishterët nuk i besojnë inspirimit verbal të Biblës”. Kështu që Zoti, pa logjikuar, nuk do ta rrëfente dy herë të njëjtin tregim. Vetëm duart e njerëzve kanë bërë kërdi me të ashtuquajturën Fjalë të Zotit – Biblën. Akoma, pra, dërmuesit e Biblës insistojnë në ate se “çdo fjalë, presje dhe pikë e Biblës është Fjalë e Zotit!”

KAPTINA VII

TESTI PA SHIJE

Si mund të dimë ne se libri për të cilin pohohet se është i Zotit, është me të vërtetë Libri i Zotit? Njëri nga testet përkundër sumë resteve të tilla, se një Mesazh, që rrjedhë nga një Qenie e Gjithëdijshme, do të jetë në pajtim me veten. Ky duhet të lirohet nga të gjitha mospajtimet dhe kontradiktat.

Pikërisht kështu është thënë në Testamentin e Fundit, librin e Zotit:

A MOS PO E SHQYRTOJNË KUR'ANIN ME KUJDES A MUND TË JETË KY NGA NDOKUSH TJETËR POS ALLAHUT NË TE DO TË GJENDESHIN SHUMË MOSPAJTIME. (Kur'ani i Shenjtë 4:82)

ZOTI APO SHEJTANI

Nëse Zoti i Gjithëfuqishëm dëshiron të na vërtetojë besueshmërisë e Librit të tij (kur'ani i Shenjtë), me këtë test pa shije, atëherë pse nuk plikohet i njëjti test në ndonjë Libër tjetër për të pohuar se është nga AI? Ne nuk dëshirojmë që askend ta mashtrojmë me fjalë sikur që kanë bërë të krishterët. Atëherë, kjo do të përputhet me të dhënat që i kemi dhënë nga dijetarët krishterë, të cilët na kanë bindur se Bibla NUK është Fjalë e Zotit, b ile, na shtyejnë të besojmë se na kanë bindur.

Një shembull klasik i kësaj sëmundjeje ishte evidencuar përsëri në “Yesterday”. Këshilli Kishtar ishte i tubuar në Grahamstown (Grehëmstaun). Arkipeshkivi i njohur Bill Burnett (Bill Bërnët) i predikonte të tubuarve. Ai krijoi një konfuzion në Bashkësinë Anglikane. Një erudit anglez iu drejtua një grupi priftërinjesh dhe peshkopësh anglezë në gjuhën e tyre (anglisht), gjë që kolegët e tij dijetarë e keqkuptuan tërësisht: deri në atë shkallë sa që Mr. Mc Millan (Mek Millan), sigurisht anglikan, redaktor i së përditshmes “The natal mercury” (Zhiva e Lindjes), e datës 11 dhjetor 1979, flet për konfuzionin të cilin e bëri arkipeshkvi në mesin e priftërisë.

SHËNIMET E ARKIPESHKVIT BURNETT (Barnet), ISHIN TË VJETRA TË KUPTOHEN SI MODEL PËR KËSHILLIN KISHTAR, DHE ISHIN KEQ TË INTERPRETUARA NË MËNYRË DRAMATIKE PËR SHUMË VETË TË PRANISHËM.

Asgjë të keqe nuk ka me anglishtën si gjuhë, por a nuk po e shihni se i krishteri, në pikëpamje fetare është i ngatërruar? “Buka” në kungimin e tij të Shenjtë, nuk është “Bukë” por “Mish”(?). “Vera” është “Gjak”(?). “trash” është si “Një” dhe njeriu është “Hyjni”(?). por. Mos gaboni, kur ka të bëjë me mbretërinë tokësore, kjo nuk është aq e thjeshtë. Duhet të keni kujdes shumë të madh nëse bëni farë marrëveshje me të. Ai mund të ju mashtrojë derisa ju atë do ta kishit bërë.

Shembuj që do t’i paraqesim në pikat kryesore, do të na tregojnë në mënyrë të qartë për kundërthëniet e librit të ashtuquajtura të

Zotit, se ato shumë lehtë bien në sy, bile edhe një fëmijë këtë e kupton.

Ju do të shihni se autorët e Librave KRONIKAT (Chronicles) dhe “Samuel” (Semjuel), na tregojnë të njëjtën storie të Daudit (David), i cili e bëri regjistrimin e hebrenjëve. Ku “inspirua” Daudi që këtë novelë ta bëjë vepër? Autori i Samuilut (Samuel) 2:24:1, thekson se ai i cili këtë e ka “provokuar” ka qenë “SATANA” (Djalli), e cila e shtyri Daudin që ta bëjë këtë poshtërim! Në cilën fe “SATANA” është sinonim për ZOTIN? Nuk jam duke folur për “Sanatizëm”, i cili është në Krishterim si kërpudhat duke u rritur, të cilën shumë krishterë e mbajmë për Zotin e tyre (?). Krishtërimi është fryt i shumë izmave: Ateizmi, Komunizmi, Fashizmi, Totalitarizmi, Nazizmi, Mormonizmi, Monizmi, Shkencërimi Krishter dhe tani Sanatizmi. Edhe çka tjetër mund të lind nga Krishtërimi?

Neve duhet ta adhurojmë duhet ta adhurojmë modestinë e dijetarëve të Biblës, por ato shkrime, si “mundësitë“, dhe “ngjajshmërit” janë asi soji të mbarështruara si të ishte fjala se këto i kanë bërë si delet e qethura. Përse shkrimtarët anonimë e bëjnë ezrën e gjerë dhe Isain si ishin cjep shusharës?

Bibla e Shenjtë i përshtatet të gjitha llojeve të interpretimeve me kundërthënie. Me këtë krishterët bile lavdërohen! Disa, me të drejtë pohojnë se disa kaptina të Biblës vazhdimisht janë keqpërdorur dhe keq përshtatur, për ta verifikuar gati çdo të keqeaty të pranishme, e që i di njeriu. Nga “E vërteta e Qartë“

(The Plain Truth), një gazetë amerikane krishtere, ndaras duke treguar lojalitetin ndaj Zotit, qysh gjithkund shënohet, ashtu i jep rëndësi edhe satanës. Kjo dihotomi e autorit të Kronikave mbeten si një lloj storie të një gruaje plakë, e cila një kandelë e ndez për Sh. Mikailin (St. michel) dhe në anën tjetër, një për dreqin. Sh. mikaili ishte i shkelur me Këmbëm, andaj ajo ka shkuar në Qiell ose në Ferr, ku i kaedhe shokët e saj. Kjo mund të shihet nga kronikat e poshtë shënuara:

SAMULI II; 24

NUMËRIMI

DHE PËRSËRI U NDEZ ZEMËRIMI I ZOTTI NDAJ IZRAELIT, DHE E DETYROIDAUDIN TË THOTË; SHKO DHE BËRE NUMRIMIN E HEBRENJËVE DHE JUDEJËVE.

Derisa autori i Samuilin 24 e konsideron Zotin si pronar të situatës autori i KRONIKAVE I, kështu mendon:

KRONIKAT I:21

NUMRIMI

DHE SATANA QËNDRON KUNDËR IZRAELIT DHE E DETYROI DAUDIN QË T'I NUMËROJË IZRAELITËT.

Ky autor i kronikave na bën të ditur se ai kishte një shok në Oborrin e Sipërm, sikurse që kishte edhe një Oborr të poshtëm. Ai kë preferuar që t'i ketë dy mundësi: ta kërkojë një ëmbëlsirë dhe atë ta hajë.

Ajo gazetë titullohej kështu: “BIBLA-libri me kundërthënie më të mëdha” (korrik, 1975).

KUSH JANË AUTORËT E VËRTETË?

Si evidente më tej është parashtrimi nga SAMULI dhe KRONIKAT, të cilin e konsideroj si këshilla të para për ta caktuar autorësinë e tyre, në vend se të dyshohet Zoti në mospërputhshmërinë e këtyre librave. Reviduesit e RSV-së thonë:

- a. SAMULI: Autor i Pahjohur, (një fjalë e vetme)
- b. KRONIKAT: Autor të panjohur, ndoshta janë mbledhur dhe përpunuar nga Ezra.

TRE APO SHTATË?

Shiko reprodukimin e faqes vijuese, krahaso dy citimet. Samuili 2, 36:5, na tregon se “Këto fjalë, fjalë për fjalë përsëriten në Kronikat 1:21;11, përpos fjalëve të panevojshme. DHE, ATIJ I THA SE ATO JANË HEQUR. Por, përse stolisen frazat e panevojshme, edhe autori poashtu e krasitë faktorin e kohës prej SHTATË vjetëve në TRI vjet? Çka u tha ZOTI-TRI apo SHTATË vjet mortajë në të dy shtëpitë e juaja?

TETË APO TETËMBËDHJETË?

Bëre një krahasim në dy citimet e faqes vijuese! Kronikat 2, 36:9

tregojnë se JEHOJAKINI ishte tetëvjeçar kur filloi të mbretërojë, drisa në Mbretërit 2,24:8 thuhet se ai ishte tetëmbdhjetëvjeçar. Autori i panjohur i Mbertërve (Kings) ka logjikuar se fëmiu tetëvjeçar mund të bëjë ndonjë “të keqe” sa për të merituar abdikimin, prandaj ky me të drejtë ia shtoi dhjetë vjet, për ta bërë JEHOJAKININ mjaft të pjekur, që të ketë përgjegjësi ndaj zemërimit të Zotit. Andaj ky e balancoi kohën, kështu që e shkurttoi mbretërinë e tij për 10 ditë! Pyesim: A mundet Zoti i Gjithëfuqishëm t’i thotë dy gjëra të ndryshme rreth të njëjtës temë?

KALORËSI APO KËMBËSORI?

Krahaso dy citimet tjera në faqen vijuese! Sa kalorës të Karrocave i ka therrur? Shtatëqind ose shtatë mijë? dhe a i ka therrur 40.000 kalorës apo 40.000 këmbësorë? Ngatërrimet në këto të dhëna në mes Samuil 2:10:18 dhe Kronikave 1:19:18 janë shumë të mëdha, “ndoshta” për arsye se Zoti nuk i ka dalluar qindshet prej mijësheve, apo nuk diti të dallojë kalorësinë prej këmbësorisë! Por, me siguri është se kjo blasfemi maskarade në fjalorin krishter është si një “inspirim”!

ÇKA KA ÇAKTUAR ZOTI: TRE VJET URIE APO SHTATË?

MORTAJA

SAMUILI, II; 24:13

13. DHE ZOTI ERDHI TEK DAVUDI (DAVIDI) DHE I TREGOI, I THA: A LE TË VIJNË SHTATË VJET URIE TEK JU NË KËTË VEND? OSE, A MUND T'I SHMANGENI ARMIQVE TRE MUAJ PARA SE TË JU NDJEKIN?

KRONIKAT I; 21:11

11. DHE KËSHTU ZOTI ERDHI TEK DAVIDI DHE I THA: KËSHTU KA URDHË RUAR ZOTI (LORDI), ZGJEDHNI VETË! 12. TRI VJET URIE OSE TRE MUAJ TË SHKATËRRUAR PARA ARMIKUT, DERISA SHPATA E ARMIKUT TË KAPËRCEJ NËPËR JU;

Sikur Zoti të ishte autor i çdo fjale, prejse dhe pika në Bibël, si që pohojnë krishterët, atëherë a është Ai autor edhe i një papajtueshmërie aritmetike?

SA VJEQAR ISHTE JEHOJAKINI, 8 APO 18?

Në mes tetë dhe tetëmbëdhjetë viteve është një hapësirë prej plotë dhjetë viteve. A mund të themi Zoti i Gjithdijshtëm dhe i Gjithfuqishëm nuk diti të numërojë, dhe kështu, nuk diti dallimin në mes 8 dhe 18? Nëse ne i besojmë Biblës si Fjalë e Zotit, atëherë

dhe Statusi i Gjithfuqishmit nuk do ta merr parasysh ligjin e të gjitha kohëve!

KRONIKAT II;36

9. JEHOJAKINI ISHTE TETËVJEQAR KUR FILLOI TË MBETËROJË , DHE AI SUNDOI TRE MUAJ E DHJETË DITË NË JERUZALEM: DHE, AI E BËRI ATË MË TË KEQËN QË ISHTE PËR ZOTIN.

MBRETËRIT (Kings) II:24

8. JEHOJAKINI ISHTE TETËMBDHJETËVJEÇAR KUR FILLOI TË SUNDOJË DHE NË JERUSALEM TRE MUAJ. NËNA E TIJ QUHET NEBUSHTA, E CILA ISHTE VAJZA E ELNATHANIT TË JERUSALEMIT.

700 APO 7000?

Për adhuruesit e biblës plotësisht e pavlerë një zero (0), e cila iu shtua 700 ose 7000, kështu, duke i ngatërruar edhe mëtej numrat biblik, u ngatërrua edhe matematika!

SAMUILI II;10

18 EDHE SIRIANËT SHPËTUAN PARA IZRAELIT: DHE DAUDI (Daudi) I THERRI NJERËZIT E 700 KARROCAVE TË SIRIANËVE, DHE DYZETMIJË KALORËS DHE GODITI SHOPHAKUN (Shofak), KAPITENIN E TURMËS, I CILI VDIQ.

ZOTI E NGATËRROI “KALORËSINË” DHE “KËMBËSORINË!

Pasi që për “Shkrimtarët e inspiruar” dhe “kalorësisë“, është shumë serioz fakti se këtu akuzohet Zoti, se burim i “inspirimit”, për mosdije. Ose, a është e mundur që sirianët, të cilët i shpëtuan Izraelit, të jenë bisha përrallore (rasë e krijesave me trup dhe këmbë të kalit dhe trung njeriu, koka dhe duar të njeriut). A është e mundur që këto krijesa, posa të arritura nga mitologjia klasike, t’i hutojnë këta autorë të mashtruar. Zoti jo vetëm që nuk di të bëjë dallimin në mes qindësheve dhe mijësheve? Ai nuk di as të dallojë “këmbësorinë“ prej “kalorësisë“? Pa dyshim ky përgjërëm (blasfemi) shtiret në fjalorin krishterë si “inspirim”!

DETYRAT PRAKTIKE TË SHTËPISË

Solomoni në famën e tij filloi ta ndërtojë një pallat mbretëror për veti, i cili ia morri trembëdhjetë vite. Ne këtë e mësuam në librin e parë të “Kindsit”, kaptina e shtatë. A ju kujtohet lavdërimi i Dr. Perkerit (faqe 28), se ”të gjitha faqet janë marrë nga emra të paqartë“? Pra , për këtë qartësi të mirëfilltë, ju nuk mund ta fajësoni kaptinën e shtatë apo Ezekiel - kaptina 45. Ju i keni borxh vetit që patjetër t’a lexoni atë, vetëm një herë në jetën tuaj. Pastaj, me të vërtetë do ta çmoni Kur’anin e Shenjtë. Nëse nuk keni Bibël dhe jeni mysliman, ju mund ta merrni ate falas nga adresa e shënuar në fund të kësaj faqe. Pastaj mund t’i ndriçoni shënimet e kësaj broshure me Biblën. “Ngjyra e Verdhë“ paraqet të gjitha

kontradiktat, “e kuqja” – paragrafet pornografike dhe e “gjelbërta” për senzibilitet, citime të pranueshme sikur që një herë i kam përmendur në fillim të këtij eseu – fjalët, të cilat mund t’i njihni lehtë se janë të Zotit dhe të të dërguarve të Tij të Shenjtë!

Vetëm me kaq ju mund të kundërshtoni ndonjë misionar apo ndonjë dijetar të Biblës, që ju del para! “NËSE NE MË SHUMË DJRSITEMI NË PAQË! MË PAK DO TË DERDHIM GJAK NË LUFTË”. (Chiang Kai-SHEK) (Çiang Kai-shek)

ÇFARË HIGJENE?

Shiko në citimet vijuese se autori i 1 Kings 7:26, i ka numëruar 2000 banjo në pallatin e Sollomonit, por autori i Chronicles 4:5, e zmadhon këtë numër mbretëror për 50% - 3000! Çfarë ekstavagance dhe gabimi në librin e Zotit. Bile edhe nëse Zoti nuk ka çfarë të bëjë tjetër, a do ta okuponte Vetën duke “Inspiruar” një pakuptimësi aq triviale për hebrenjtë? A është Bibla Libri i Zotit? A është Ajo Fjalë e Zotit?

NJË SËRË KONTRADIKTASH

Para se ta konkludojë këtë seri kontradiktash, më lejoni të jap vetëm edhe një shembull. Qindra sosh gjenden në Bibël. Shiko faqet vijuese, përsëri Sollomoni. Ai vërtetë bënë gjëra në mënyrë të madhe. Ish-Shahu i Iranit ishte bir i çerdhes së fëmijëve. Autori i Chronicles 9:25 i dha Sollomonit 10.000 shtalla të kuajve më shumë se banja. “Pra Sollomoni i kishte 4000 shtalla të kuajve ... “Por autori i 1 Kings 4:26 vërtetë kishte mendime mbretërore për zoptin e tij mbretëror. Ai e shumëzoi numrin e shtallave të Sollomonit me 100%- dhe prej 4000 u bënë 40.000 sosh.

DALLIMI “2000 DHE 3000 ËSHTË VETËM PËR 50% I RRITUR!

MBRETËRIT I:7

26. DHE ISHTE I DENUAR VETËM SA GJERËSIA E DORËS, DHE SKAJI I SAJ ISHTE I PUNUAR SI SKAJI I FILXJHANTIT, ME LULE ZAMBABU: PËRBËHEJ NGA DYMIJË BANJO.

KRONIKAT II:4

5. DHE DENDËSIA E TIJ ISHTE SA GJERËSIA E DORËS, DHE SKAJI I TIJ ISHTE SI PUNA E SKAJIT TË FILXJHANTIT, ME LULE ZAMBAKU, DHE AI PËRBËHEJ NGA 3000 BANJO.

Pa marrë parasysh se a është apo nuk është qesharake mungesa e aftësisë së autorit “të inspiruar” që të dallojë 2000 prej 3000,

mirëpo, se kjo nuk falet! Është një kontradiktë e qartë. Dhe, ASNJË MREKULLI NUK MUND TË POHOJË SE DY EDHE DY BËJNË PESË! OSE, KUR THEMI QË RRETHI I KA KATËR KËNDE! Dhe, ASNJË MREKULLI NUK MUND TA INJOROJNË KONTRADIKTËN E CILA GJENDET NË SFERAT E MËSIMEVE DHE SHËNIMEVE KRISHTERE”

(Albert Schweizer), nga libri i tij: “Në kërkim të Jezuit Historik”, faqe 22, autori i Mbretërve I;4:26, ka menduar në mënyrën mbretërore që ishte patron i tij. Ai i ka shumëzuar shtallat e Sollomonit me 1000%, prej 4000 ka dalur në 40.000! Dikur, disa evangjelistë gojëmbël mashtronin se dallimi është vetëm në një 0 (zero), se disa shkrues apo kopjues, nga pakujdesia, ia kanë shtuar një zero, dhe kjo është bërë 40.000! Më lejoni të ju tregoj se hebrenjtë në kohën e Sollomonit, nuk kanë ditur sagjë për zeron. Hebrenjtë, në veprat e tyre, numrat i shënonin me shkronja ew jo me numra. Pyetja jonë është kjo: Kush është autor i kësaj diskprance hutuese për 36.000? A ka qenë Zoti apo njeriu? Këto shënime dhe shumë fakte të tilla mund t’i gjeni në librin e njohur: “THE BIBLE – WORD OF THEGOD OR OF MAN?”

(Bibla, fjalë e Zotit apo e njeriut) – nga A. S. K. JOOMMAL (Xhumal).

**DALLIMI NË MES 4 MIJË DHE 40 MIJË ËSHTE
VETËM 36.000!**

KRONIKAT II

KAPTINA 9

25. DHE, SOLLOMONI (Sylejmani) KISHTE KATËRMIJË SHTALLA TË KUAJVE DHE KARROCA, DHE, DYMBËDHJETË-MIJË KALORËS, TË CILËT AI I SHPËEBLEU NË QYTETIN E KARROCAVE, DHE, ME MBRETIN E JERUZALEMIT.

MBRETËRIT (Kings) I

KAPTINA 4

26. DHE, SOLLOMONI KISHTE KATËRDHJETËMIJË SHTALLA TË KUAJVE PËR KARROCA, DHE DYMBËDHJETËMIJË KALORËS.

HEBRENJTË NUK KANË PËRDORUR “O” NË TESMENTIN E VJETËR

DËSHMIA MË OBJEKTIVE

Propaguesi krishter ka shumë dëshirë t'i citojë vargjet vijuese si dëshmi se Bibla e tij është Fjalë e Zotit.

“I TËRË SHKRIMI I SHENJTË ËSHTË DHËNË NGA INSPIRIMI I ZOTI, DHE ËSHTË I DOMOSDOSHËM PËR MËSIM, QORTIM, KORRIGJIM, DHE PËR INSTRUKCIONE PËR DREJTËSI.” (2 Timothy 3:16 – AV nga Scofield (skofild)).

Shih se “ËSHTË” – është shënuar me shkronjë të mëdha. Rev. Skofild na tregon se ato nuk na paraqiten në greqishtën origjinale. “BIBLA ANGLEZE” e përkthyer nga Komiteti Përfaqesues i Kishës Angleze, Skotlandeze, Protestante, Kishës Kongegacioniste, Unionit Baptist, Kishës Skotlandeze (më të vjetër) në Angli, etj. Etj .., dhe Shoqata Biblike Britanike edhe Ajo e huaj, e kanë bërë përkthimin më të afërt me origjinalin Grek, i cili vlen të riprodhohet këtu : “ÇDO SHKRIM I SHENJTË FRYMËZUES PËRDORET PËR MËSIMIN E SË VËRTETËS DHE PËRGËNJESHTRIMIN E GABIMEVE, OSE PËR REFORMËN E MËNYRES DHE DISIPLINËS SË JETËS SË DREJTË.” (2 Timothy 3:16)

Romano-Katolikët në versionin e tyre “Douay”, i janë të

gjithashtu më besnik tekstit se sa protestantët në Versionin e tyre të Autorizuar (AV). Ata thonë: Çdo shkrim i Shenjtë i frymëzuar nga Zoti është i dobishëm për të mësuar, kritikuar dhe korrigjuar ...”

Ne nuk do t'i bishtewrojmë këto fjalë. Myslimanët dhe katolikët pajtohen me atë se çfarëdo që vjen nga Zoti me anë të frymëzimeve apo revelatës, duhet të shërbejë për njeriun nga këto qëllime:

- 1) Ajo duhet të na mësojë BESIM;
- 2) Të na KRITIKOJË për gabimet tona;
- 3) Të na ofrojë PËRMIRËSIM;
- 4) Të na udhëzojë në DREJTËSI.

Rreth katërdhjetë viteve kam pyetur shumë dijetarë krishterë, se a mund ta paisin gozhdën e pestë për ta varur Fjalën e Zotit. Ata dështuan tërësisht. Kjo nuk do të thotë se unë u përmirësova kundrejt paraqitjes së tyre. Më lejoni të egzaminoj “Biblën e Shenjtë” me këto teste objektive.

JO FORT LARG PËR TU KËRKUAR

Libri më i parë i Biblës “GENESIS” (Gjenezis) – na ofron shumë shembuj të bukur. Hape kaptinën e 38 dhe lexo. Këtu është dhën historia□ e Judës, babait të racës hebraike, prej nga ne derivojmë emrat “Judea” dhe “Judaizëm”. Ky patrik hebre u martua dhe Zoti ia fali tre djem: Er, Onan dhe Shelah. Kur, biri i parë u rrit, Juda e martoi me zonjën e quajtur tamar.

□ Ju kujtohet Dr. Keneth Cragg – në “thirrja nga Minarja” dhe “Historia e Tij”. Shiko tërë citimin e faqes së parë. Kjo është ajo histori.

Por Eri , biri i parë i Judës, ishte i mëkatshëm para Zotit dhe Zoti e vrau. (Genesis 38:7) Ku do ta vendosshit ju këtë lajm të hidhur, në bazë të aktër primeve të timothit? – Të dytin – qortimi – është përgjigjia. Eri ishte mëkatar, andaj Zoti e mbyti. Një mësim për të gjithë. Zoti do të na shkatërrojë për mëkatet tona,

DËNIM!

Duke vazhduar këtë histori hebraike, sipas traditave të tyre, nëse vëllau vdes dhe nuk ka trashëgimtar, detyrë e vëllaut tjetër është që të jap “farën” kunatës së tij dhe të mund të përjetësohet emri i të vdekurit. Për hirë të taditës Juda e urdhëroi djalin e tij të dytin, onanin, që ta kryej detyrën. por gjelozia ia kaploi zemrën. Të jetë fara e tij, por emri i të vëllaut! Dhe në momentin kritik ai e derdhi atë në tokë. Kjo që bëri e mllefosi Zotin dhe Zoti e vrau edhe atë.

(Genesis 38:8-9). Përsëri si po përputhet kjo vrasje me testin e Timothit – DENIMI – është përgjigjia përsëri. Nuk ka lavdata për këto pëgjigje të lehta. Ato janë shumë të nevojshme. Nëse vepron keq do ta përcjellë pasojat! Onani është harruar në “Librin e Zotit”, por seksologët krishterë e kanë pavdeksuar duke e përmendur në “coitus interruptus” (bashkimi seksual i ndërprerë), si onanizmi, në “Librin e Seksit”

Tani, Juda i tha nusës së tij Tamarës të kthehet në shtëpinë e babait të saj derisa të rritet djali i tretë Shelah për ta kryer detyrën.

HAKMARRJA E GRUAS

Shelahu ishte rritur dhe ndoshta ishte martuar me tjetër grua por juda nuk e kishte realizuar premtimin që ia kishte dhënë tamarës. frikësohej thellë në zemër. Ai i kishte humbur dy djemtë për shkak të këtij “ëkati”. DRUAJ PËR FATIN E TIJ (SHELAHUT) SE MOS PO VDES EDHE AI SI VËLLEZËRIT E TIJ”. (Genesis 38:11). Kështu që Juda qëllimisht e harroi premtimin e tij. Nusja e cenuar vendosi t’i hakmerret të vjetrit për shkak të cungimit të drejtës së “farës”. Tamara kuptoi se juda do të shkon tek timothy për t’i qethur delet. Ajo planifikoi që të takohet rrugës me të. Ajo e parapriu atë dhe shkoi e u ul në një vend të hapur në rrugë për tek Timothy. Kur e pa juda, mendoi se ishte ndonjë lavire ngase ajo e kishte mbuluar fytyrën e saj. Ai iu afrua dhe i propozoi: “MË LEJONI TË HYJ NË JU, DHE AJO : ÇFARË MË JEP NËSE DËSHIRON TË HYSH NË MUA?” Ai i premtoi se do t’ia

dërgojë një edh nga kopeja e tij. Si mund të besonte se ai vërtetë do ta mban fjalën? Çfarë garance kërkon ti?” – pyeti Juda. “Unazën e tij, bylyzykun e tij dhe personelin e tij” – përgjigjja ishte e gatshme. Plaku ia dhuroi këto dhe “HURI NË TË, DHE AJO U MBARS NGA AI” (GENESIS 38:16-18).

NJË MËSIM MORAL

Para se të kërkojmë titullin nga Timothy 3:16, se në ç’vend ta kategorizojmë këtë tregim të ndyrë në “Librin e zotit”, dua të pyes atë që edhe ju kishit dashur të pyetni: “Ç’është morali?”, mësim të cilin fëmijët tanë do ta mësojnë nga hakmarrja e Tamarës? Natyrisht, ne fëmijëve tanë u tregojmë se fabulat e num kanë kurrfarë vlere por përmes tyre njeriu sado pak mund të edukohet. Tregimet “Dhëpra dhe mishi”, “ujku dhe qengji”, “Qeni dhe hija e tij” etj., sado që janë të thjeshta, ka pak edukatë në to.

DILEMAT PRINDËRORE KRISHTERE

Një psikolog i famshëm Dr. Vernon Jones (Vernën Xhons), ka bërë disa eksperimente me disa grupe nxënësish, të cilëve iu janë treguar tregime të njëjta. Heronjtë e tregimeve ishin të njëjtë për të gjitha grupet e nxënësve, por ata silleshin në mënyra të ndryshme. Për njeriun grup p.sh. Shën Gjergji “duke e mbytur kuçedrën” paraqet një fytyrë të fuqishme, mirëpo në grupin tjetër ai paraqitet “duke i ikur terrorit dhe duke kërkuar strehim në prehër të nënës.

“KËTO TREGIME LANË PËRSHTYPJE TË NJËJTA POR ME NDRYSHIME PERMANENTE NË KARAKTER BILE EDHE NË RRETHIN MË TË NGUSHTË TË NXËNËSVE!” – KONKLUDOI Dr. Xhons.

Se çfarë dëmi kanë bërë, “grabitjet dhe vrasjet, insektet dhe bishat” e Biblës, tek fëmijët krishter, mund të matet në raportet e gazetave ditpre. Nëse kjo është burim i moralit perëndimor, pra sigurisht që protestantët dhe romano-katolikët e kanë solemnizuar martesën në mes HOMOSEKSUALËVE, në “Shtëpinë e tyre të Zotit”. “Dhe” 8000 “gays” (një shprehje për homoseksualë) paraduan “poqëritë” e tyre në Hajd Park të Londrës, në korrik 1979, që të pranohen nga lajmet dhe TV mediat.

Ju duhet ta merrni atë “Bibël të Shenjtë“, dhe ta lexoni tërë kaptënën e 38 GENESIS. Nënvido me ngjyrë të kuqe fjalët dhe frazat që e meritojnë këtë zbulim! Ne e kemi arritur vargun e tetëmbëdhjetë nga mësimi moral?

“DHE AJO U MBARËSUA NGA AI”!

NUK MUND TË FSHIHET PËRGJITHMONË

Me zhvillimin e gjërave, pas tre muajsh i erdhi lajmi Judës se nusja e tij tamara ishte si lavire dhe se ishte me fëmijë nga shtatëzënia me Judën. juda tha: “SILLEN I ATE KËTU DHE DIGJENI” (Genesis 38:24). Juda qëllimisht e ka përbuzur atë si “shtrig”, dhe tani dëshiron që ajo të digjet. Por kjo hebrije dinake,

njëherë ishte mbi plakun. Ajo ia dërgoi unazën, bylyzukun dhe shkopin e tij nëpërmjet një shërbtori, duke e lutur të vjehrrin që të gjejë fajtorin, përgjegjës për shtatëzëninë e saj. Juda ishte në cak. Ai e pranoi se nusja e tij kishte të drejtë edhe më tepër se ai vet. "“HE AI NUK E NJIHTE ATË MË SHUMË” (vargu 26). Kjo është një përvojë që të gjendet zgjidhja e gjuhës, në të cilën përshkruhen versione të ndryshme të të njëjtit incident. Dëshmitarët e Jehovahës në “New World translation” (Përkthimi i botës së re), citimin e fundit e përkthejnë: - “PAS KËSAJ AI NUK PATI MARRËDHËNIE TJERA ME TË”.¹⁵ Ky version nuk është version i fundit që ne e dëgjojmë në “Librin e Zotit”, për Tamarën, të cilën e përjetësojnë shkrimtarët ungjillor në: “Genealogy of Their Lord” (Historia Familare e Zotit të tyre).

¹⁵ Versioni i dëshmitarëve të Jehovahës është më i pabesueshmi për zgjedhjen e fjalëve – Ai nuk mëdyshet që “lopatën” ta quaj “lopatë“. Krahazo Ezekeil, 23 me ndonjë version tjetër dhe gjeje dallimin!

Kaptina VIII

INCEST I “NDERUAR”

Unë nuk dua që t’ju lodhi me detaje, por vargjet e fundit genesis 38 merren me duelin e mitrës së Tamarës: rreth binjakëve, të cilët luftonin për përparësi. Hebrenjtë ishin shumë të përpikte në shënimet e “lindjes së parë”. Lindja e parë merr pjesë më të madhe të trashëgimisë atërore. A thua kush është fitues fatlum në këtë garë paralindore? Janë katër në këtë kontest të vetën. Ata janë “PHAREZ (Farezi) dhe Zahari nga TAMARA DHE JUDA”! Si? Tani do të shihni. Por së pari na lejon të jemi të moralshëm. Çka është morali, në këtë epizodë? Ju kujtohen Eri dhe Onani? Si i shkatërroi Zoti për shumë mëkate? Dhe mësimi që bëme në secilin rast ishte “DËNIM”. Në çfarë kategorie të Tímothit ju do ta vendosnit këtë çnderimtë Judës, si dhe këtë stërnipni të paligjshme? Të gjitha këta personazhe ndrrohen në “Librin e Zotit” për bastardhinë e tyre! Ata bëhen gjyshër të mëdhenjtë si dhe të mëdha “TË TË VETMIT BIR TË LINDUR NGA ZOTI”(?)

Shiko mateu 1:3, ku në secilën version të Biblës, krishterët i kanë shkruajtur këta emëra ndryshe në krahasim me këta që i kanë gjetur në “Dhjatën e Vjetër” (Genesis – kaptina 38), me këto të përmbajutra në “Dhjatën e Re” (Mateu – kaptina 1), që të lë lexuesin pa kundërim. Prej “Pharez” në të vjetrin në “Pares” në atë

të riun Zarah në Zara dhe Tamar nëThamar. Por ç'ndodhi me moralin? Zoti e bekoj Judën për krimin e incesit! Kështu, nëse ti bën keq (ER), Zoti do të mbys ty, nëse derdhë (farë) Onan, Zoti do të mbytë. Por nusja (Lamat), e cila në mënyrë shpaguese dhe dhëlpërake mbledhë “farën” e të vjehrit, shpërblehet. Në çfarë kategorie, krishterët do ta vendosin këtë “nderë” në “Librin e Zotit” Me çka përputhet ky? A është ... kjo gjë e juaj?

1. MËSIMI
2. DËNIMI
3. PËRMIRËSIMI? Apo
4. INSTRUKSIONE PËR DREJTËSI

Pyete ate, i cili të trket në derë - atë të luftës profesional. Atë ungjillor të denjë, atë dërmues të Biblës. Ai këtu e meriton një shpërblim po qe se na jep një sqarim për përgjegje korrekte. Asnjë bir nëne nuk mund ta arsyetojë këtë ndytësi, këtë pornografi të ndonjërit nga titujt e lartpërmendur. Por titull duhet të shëndrrohet në “PORNOGRAFI”

NDALOJE JIBRIN

George Bernard Show (Xhorxh bernard Sho) ka thënë: “Libri më i rrezikshëm në tokë 9Bibla)” – mbaje nën dry dhe qelës”. “Mbaje larg fëmijëve tuaj”. Por kush i përmbahet këshillave të tij? Ai nuk ishte “B.A.” një krishter i “rilindur”¹⁶. Sipas parimit të moralit të lartë të rregullave krishtere të Afrikës Jugore, të cilat e kanë ndaluar librin “Lady Chaterly’s Lovers” (I dashuri i Znj. Çetërli), për shkak të “tetragrammaton” – një fjalë e katër shkronjave. Ata sigurisht do ta ndalonin “Biblën e Shenjtë” po të ishte libër fetare për Hindusë apo Myslimanë. Por ata janë totalisht të paafte ndaj “librit të tyre të Shenjtë”, Shpëtimi i tyre varet nga ata!

Leximi i tregimeve Biblike tek fëmijët mund t'i ofrojë rastet për diskutimin e edukatës seksuale. Një Bibël e pastruar të ketë një -X- llogari tatimore nga disa cenzurues. The plain Truth – (E vërteta e thjeshtë) October 1997

¹⁶ “B. A” (born again) është një sëm undje e re. Ajo ka shkatërruar “kultin e vetëvrasjes” të reverendit Xhim Xhons (Jim Jones) në xhonstaun (Jonestown) në Gujana të Amerikës Jugore

VAJZAT MASHTROJNË BABËN E TYRE

Lexo genesis 19, vargjet 30 deri në fund, dhe përsëri nënvizoj me ngjyrë të “kuqe” fjalët dhe frazat që e meritojnë këtë nderë. Mos u hamend dhe mos e zgjat. Bibla e juaj e ngjyrosur do të bëhet trashëgimi për fëmijët e juaj. Unë konkretisht, pajtohem me shoun që ta mbajmë Biblën “nën qelës dhe dry” – por neve na duhet kjo armë për tu shtyer me krishterët. Profeti islam tha: “Lufta është strategji”, dhe strategjia kërkon që t’i përdorim armët e armikut tonë. Kjo nuk varet nga dëshira jonë. Kjo është ajo që jemi të detyruar të përdorim kundër një “Libri”, profesorët, të cilët na trokasën në dyert tona me: “Bibla thotë kështu” dhe “Bibla thotë ashtu”. Ata duan që të na këmbëjnë Kur’anin e Shenjtë me Biblën e Shenjtë. Tregoju atyre zbrastësirat në mesin e zbrastësirave të cilat ende nuk i kanë parë. Prej kohësh, këto forca mbinatyrore shtirreshin se gjoja nuk i kanë parë këto ndytësi dhe se po i shohin për herë të parë. Ata ishin të programuar me vargie të zgjedhura për propagandë.

Të vazhdojmë: “historia” e ka që për çdo natë vajzat e lotit mashtrojnë babanë e tyre të dehur me motivin fisnik(?) të mbarsohen me farën e babait të tyre. “Fara” përmendet shumë në këtë “Libër të Shenjtë”: dyzet e shtatë herë paraqiten vetëm në broshurën e vogël të Genesis ... përpos kësaj marrëdhënja tjetër shndërruese është “AMONITë” dhe “MOABITë”, andaj të cilëve si duket, Zoti i hebrnjëve ka pasur shumë mëshirë. Më tutje në Bibël mësojmë se hebrenjtë ishin të urdhëruar nga i njëjti Zot i mëshirshëm që pa mëshirë t’i mbysin Filistejtët burrat, gratë dhe

fëmijët. Bile të mos kursehen as drunjtë e as shtazët. por Amonitët dhe Moabitët nuk duhet të “pikëllohen” e as “të trazohen” për këtë sepse ata janë farë e Lulit! (Deuteronomy 2:19).

Asnjë lexues i mirë nuk mund të lexojë këtë lajkatim të Lutit ndaj nënës së tij, motrës ose vakzës bile as të fejuarës, nëse ajo është e ndershme dhe e moralshme. Edhe ju nuk mund të hasni në njerëz të mbrapshtë, të cilët e gëlltisnin këtë ndytësi. Shija mund të kultivohet!

Lexo përsëri dhe nënvizo në Ezekiel 23. Ju e dini se çfarë gjëje e ndytë duhet të jetë lapërdhia e dy motrave Aholah dhe Aholibah. Detajet seksuale këtu turpërojnë bile edhe botimet e papastruara të librave të ndaluara. Pyetni të “lindurit përsëri”, “Vizitorët krishterë se në çfarë kategorie do të klasifikonin këtë lapërdhi? Një ndytësi e tillë sigurisht që nuk ka vend në ndonjë “Libër të Zotit”.

AL-GAJ-A.D. ALIJOLA (Al-haxh-Alixholla), në librin e tij – THE MYTH OF THE CROSS (Legjenda e kryqit), me mjeshtëri tregon për gabimet e biblës, gabimin e të kryqarit, si dhe të Krishtërit në përgjithësi. Ata të cilët janë të interesuar për religjionin përkatës duhet, patjetër, ta kenë edhe këtë botim që flet mbi Biblën: THE BIBLE: WORD OF GOD or WORD OF MAN? (Bibla: Fjalë e Zotit apo e njeriut?), përndryshe është përmendur në këtë broshurë.

Kaptina IX

GENEALOGJIA E JEZUIT

Shiko si baballarët tanë krishterë i kanë marrë në qafë bijtë e tyre të incestit në Dhjatën e Vjtër ndaj Zotit dhe shpëtimtarit të tyre në Dhjatën e Re. Për njëriun, i cili, nuk kishte fare gjenealogji ata ia kurdisën një, dhe çfarë trashëgëmie se Gjashtë perversë dhe filliza të shëndrrimit iu atribuuan njeriut të Zotit. Sipas Ligjit të Zotit, burrat dhe gratë meritojnë të vriten me gurë, sikur që është treguar nga moses (Musai), dhe më vonë tË mospërfillen (shporen nga shoqëria) dhe me gjenerata t'u hiqet e drejta nga shtëpia e Zotit.¹⁷

TË PARËT TË PANDERSHËM

Pse Zoti ia jepë “babanë” Jozeph (Xhozëf) “birin” të tij Jezuit, dhe pse një stërgjyshëri aq e pandershme? “KJO ËSHTË E TËRË BUKURIA E SAJ” thotë një i mbrapsht “Zoti aq shumë i dashti mëkatarët sa që i përbuzi të mos i dhurojë trashëgimtarë të tillë birin tij”.

¹⁷ Bastardët nuk do t'i takojnë Zotit, bile as gjenerata e dhjetë: (deut: 23:2) – AV. Të ertit kanë qenë shumë të ndieshëm në këtë fjalë. Devja kur kullotë përbinë edhe mushkaja!

VETËM DY TË POROSITUR

Nga katër shkrimtarët e ungjillit, zoti i “inspiroi” vetëm dy për ta shënuar brezninë e “Birit Tij”. Dua që të ju lehtësojë ta bëni krahasimin e “etërve dhe gjyshërve” të Jezu krishtit, në të dy format e “inspiruara”. Unë i kam mbledhur vtëm emrat, pa tepriçë fjalësh. Shiko faqen vijuese, në mes Davidit (Daudit) dhe Jezuit Zoti “inspiroi” Mateun që të përkujtojë vetëm 26 stërgjyshër për “Birin e Tij”. Por Luka ishte gjithashtu i “inspiruar” dhe mblodhi 41 stërgjyshër për Jezun. I vetmi është Jozeph (Xhozef). Ju, gjithashtu mund të hasni në kontradikta të mëdha në këto lista. A mund t’a kenë ato si burim të përbashkët, p. sh. Zotin?


PROFECIA E PLOTË?

Mateu dhe luka janë shumë të zellshëm, kur e bëjnë Davidin mbret, stërgjyshi i parë i Jezuit, për shkak të mendimit të rrejtshëm se Jezui duhet të ulet në fronin e babait të tij Davidit” (ACTS 2:30). Ungjilli kundërshton këtë paralajmërim, dhe na tregon se në vend që Jezui të ulet të thronin e babait të vet (davidit), duhet të ulet Pontius Pilati, një guvernier Romak, një pagan i cili u ul në fron dhe ligjshëm e dënoi Jezuin me vdekje.

BREZNIA PTREJ DAVIDIT (DAUDIT) DERI TEK JEZUI
(ISAI)

SIAS MATEUT 1:6-16
31

SIPAS LLUKËS 3:23-



JEZUI

“S’prish punë“ thotë evangjelisti “NËSE NUK PLOTËSOHET KJO PARATHËNIE ME ARDHJEN E TIJ TË PARË, AI DO T’A PLOTËSOJË KËTË ME ARDHJEN E TIJ TË DYTË DHE POS KËSAJ NË TREQIND ARDHJE TË

TJERA. Por me entuziazmin e tyre ekstavagant që t’a gjurmojë këtë stërgjyshëri’ të Jezuit me Davidin, dhe për këtë Bibla pikërisht thotë: “Se kjo u bë nga fryti i kryqëzatave të tij (davidit), bashkë me mish”. (në mënyrë origjinale e jo metaforike, aktet, 2:30), por që të dy autorët e “inspiruar” dështuan nga hapi i parë.

Mateu, 1:16, thotë Jezui ishte biri i Davidit me anë të Solomonit, por Luka 3:31, thotë se ai (Jezui) ishte bir i davidit me anë të Nathanit. Nuk është e thënë të jesh gjinekolog dhe të dijshe se sigurisht fara e Davidit mund të mbërrijë tek nëna e Jezuit nëpërmjet të dyve në të njëjtën kohë (Solomonit dhe Nathanit)! Dhe neve e dijmë se të dy autorët janë gënjeshtarë të ngatërruar, ngase Jezui është lindur me mrekulli, pa intervenimin e mashkullit. Bile edhe nëse e pranojmë stërgjyshërinë me anë të Davidit, prapseprap të dy autorët janë gënjeshtarë për arsye të dukshme.

THYERJA E PARAGJYKIMIT

Thjeshtë thënë ashtu si është logjika e sipërpërmendur i krishteri është emocionalisht i ndërlikuar, asgjë nuk mund të depërton në mendjen e tij të cenuar. Po ia japim atij një shembull identik ku ai

mund të jetë disi në gjendje objektive. Ne nga historia e dijmë se Muhamedi, Profeti Islam, është biri i Ibrahimit me anë të Ismailit, dhe nëse ndonjë shkrimtar i “inspiruar” do që me dredhi ta shtie në dorë “revelatën” se muhamedi ishte biri i Ibrahimit me anë të Isakut, pa u hamendur fare në atë shkrimtar do ta quajmë gënjeshtar, ngase “fara” e Ibrahimit kur nuk mund të arrijë deri te Amina (nëna e Muhamedit) me anë të Ismailit dhe Isakut në të njëjtën kohë. Dallimi i breznisë në mes këtyre dy bijëve të Ibrahimit është dallimi në mes hebrenjëve dhe arabëve.

Për rastin e Muhamedit, ne e dijmë, se kushëdo të thotë se Isaku ishte stërgjyshi i tij, është gënjeshtar. Por për rastin e Jezuit që të dy, mateu dhe Luka, janë të dyshimtë. Derisa të mos vendosin krishterët se cilën linjë stërgjyshore do ta zgjedhin për Zotin e tyre, që të dy Ungjijtë duhet të kundërshtohen. Gjatë 2000 viteve të fundit krishterimi ka hasur në pengesa të mëdha duke u munduar ta gjejë këtë stërgjyshëri (ta zgjedh misterien). Ata ende nuk abstenojnë nga kjo. Ne e adhurojmë durimin e tyre. Ata ende besojnë se ”KOHA DO T’UA ZGJEDH PROBVLEMIN”.

EKZISTOJNË KONTRADIKTA TË VËRTETUARA SE TEOLOGËT NUK E KANË ZBULUAR FORMËN PËR T’I KËNAQUR ATEISTËT ME PËRGJEGJE. NË TË VËRTETË, KA VËSHTIRËSI TEKSTUALE ME TË CILAT ENDE PO BALLAFAQOHEN STUDJUESIT. VETËM NJË BIBËL E PAPËRKRYER MUND T’I MOHOJË PROBLEMET E TILLA, POR EDHE TË TJERA. “E vërteta e thjeshtë” (THE PLAIN TRUTH), korrik, 1975, për këtë problem flet në mënyrë të

bindshme.

BURIMIT I “INSPIRIMIT” TË LUKËS.

Gati 85% të Mateut, Lukës dhe deri tek marku, i theksuam në këtë vepër, bile edhe atë “Q” misterioze. Tani t’i lejojmë Lukës të na shpjegojë se kush e ka “inspiruar” të tregojë për “THEPHILUSIN E TIJ MË TË MIRË” (Luka, 1”3), për tregimin e Jezuit. Shiko në faqen vijuese për “Parathënien” e Lukës në UNGJILL. Me këtë, ai na tregon se gjendet në vijën vazhduese të të tjerëve, por të cilët ishin më pak të kualifikuar se vetë ai ..., të cilët kanë pasur guxim të shkruajnë për heroin e tyre-Jezuin. Sikurse që një mjek është më i paisur për ta krijuar një kryevepër se sa një peshkatar ose një tagrambledhës. Sipas meje, më duket seme këtë ai ka bërë “mirë” sepse është orvatë që këtë problem ta vë në rregull. Këto janë arsyetimet e theksuara që kanë të bëjnë me paraardhësit e tij.

Në parathënien e përkthimit të “Ungjillit të Shën lukës, një ekspert i krishter J. B. Philips. (Xh. B. filips) thekson këtë: “NË POHIMIN E TIJ, MË ME KUJDES TË VEÇANTË, KA BËRË NJË KRAHASIM DHE KA BOTUAR MATERIALIN EKZISTUES, POR SI DUKET, AI E KA SHTUAR NJË PJESË TË MADHE TË MATERIALIT, DHE NEVE ME ARSYE, MUND T’I NJOHIM BURIMET ME TË CILAT KY ËSHTË SHËRBYER”.

Dhe, ju ende këtë quani Fjalë të Zotit? Gjeje dhe shiko veprën “THE GOSPELS IN MODERN ENGLISH” (Ungjijtë në anglishtën bashkëhore), që është botim i shtëpisë botuese “FONTANA”. Është një edicion që shitet me një Çmim të lirë!

Gjeje sa më shpejt, para se krishterët të vendosin ta shpallin të pavlefshëm përkthimin e Filipsit! Dhe, mos u befasoni nëse autorët e RSV-së vendosin ta eliminojnë parathënien nga përkthimi i tyre! Kjo është një traditë krishtere e njohur për këso “përmirësime”. Në krishtërim është praktikë e njohur se posa të interesuarit e kuptojnë se padashje ka dalur në shesh një sekret i tyre, së shpejti këtë do ta përmirësojnë! Dhe bile, edhe këto shënime të mia gjatë natës do t’i shndërrojnë në një histori të kaluar.

PSE LUKA E SHKROI “UNGJILIN E TIJ”?

UNGJILLI SIPAS SHËN LUKËS

1. PËR SHUMICËN, të cilën e kanë Marrë në dorë me qëllim që të formulojnë një deklaratë, rreth atyre, të cilët janë më të besueshmit në mesin tonë.

2. Bile dhe nëse ata na i kanë dorëzuar dhe të cilët që nga fillimi janë dëshmitarë, dhe shërbyes të mirë të Fjalës

3. Edhe mua, gjithashtu, më vie mirë. Që E KAM KUPTUAR SHUMË mirë atë që nga fillimi, dhe ta shkruaj në rregull, Theophilusin më të shkëlqyer.

4. Dhe se ju duhet ta dini të vërtetën e këtyre gjërave, që ju mësova.

Pamja nga Versioni i Autorizuar Luka 1:1-4

UNGJILLI QË KA MBETUR

Kush është autor i “Ungjillit të Shën John (Xhonit)”, As Zoti e as Shën Xhoni. Shiko faqen vijuese se çka thotë ai “vetë për atë”(?). në faqen vijuese Xhoni, 19:35 dhe 21:24-25. Kush është “AI”, “I TIJ” dhe “KJO” d-h-e- (dhe) fjalët e tij “NE E DIJMË” dhe “UNË SUPOZOJ”? A mos është ndonjë njeri labil, i cili e la ate të luhatet në kopsht, kur ai më së tepërmi kishte nevojë, ose mos ishte njeriu i katërmëdhjetë në tavolinë, në “Last Super” (i Mrekulluari), ai të cilin “e donte Jezui”? Që të dy ishin xhona. Ky ishte një emër i popullarizuar tek hebrenjtë në kohën e Jezuit, e edhe sot është në mesin e krishterëve. Asnjëri prej tyre nuk ishte autori i këtij Ungjilli. Fakti se ky është prodhim i një dore anonime, është plotësisht i qartë.

AUTORËT NË NJË LËVOZHGË ARRE

Më lejoni të përfundoj këtë “autorësi” (burim letrar) të hulumtuar me vendimin e 32 dijetarëve të mbështetur në 50 bashkëpunorë të grupeve fetare kooperuese. Zoti, qysh herët është eliminuar nga kjo autorësi. Në RSV nga “Collins” (Kollins)

shënime të pavleshme rreth “librave të Biblës” gjenden në pjesën e prapme të prodhimeve të tyre. Në faqen vijuese po e reprodukojmë vetëm një pjesë të asaj informate. Ne po fillojmë me “Genesis” – librin e parë të Biblës. Studiusit për “autorin e saj” thonë: “NJERI NGA PESË LIBRAT E MUSAIT”. Shiko se fjalët “pesë Librat e Musait është nën thojza”. “Kjo është një mënyrë e stërholluar për të pranuar se mu kjo është ajo që thonë njerëzit – se ky është libri i Musait, se Musai është autor i saj, por ne (32 studiuesë), për të cilën jemi mirë të informuar, nuk pajtohmi me atë titull me thashethëme.

Katër librat vijuese, “EXODUS, LEVITICUS, NUMBERS DHE DEUTORONOMY”: AUTORE?

Përgjithësisht, iu besuam Musait. “Kjo është një kategori e njëjtë si libri GENESIS.

Kush është autor i librit “JOSHUA”? Përgjigjja: Pjesa më e madhe i besohet joshuas. Kush është autor i librit “JUDGES” (Gjykatësit)? Përgjigjja – “sigurisht Samueli”.

Kush është autor i “RUTH”? Përgjigjja: “Nuk dihet saktësisht” dhe kush është autori:

Samuelit të parë? Përgjigjja: autori “I panjohur”

Samuelit të dytë? Përgjigjja: autori “I panjohur”

Kingut të parë? (mbretit të parë)-Përgjigjja: autori “I panjohur”
 Kingut të dytë? (Mbretit të dytë)-Përgjigjja: autori “I panjohur”
 Kronikat I Përgjigjja: autori “I panjohur”, sigurisht ...

Kronikat II Përgjigjja: autori “i njëjtë me atë i cili e mbledhi”

VËRE! PËREMRA!

SHËN XHONI 19

35 Dhe **ai** i cili e pa atë si shënim bosh, dhe shënimi i **tij** ishte i vërtetë, dhe **ai** e diti se **ai** e foli të vërtetën, që ju mund të besoni.

KUSH ËSHTË “AI” DHE “I TIJ”?

UNGJILLI, SIPAS SHËN XHONIT

SHËN XHONI 21

24 Ky është nxënësi, i cili i vërtetoi këto gjëra, dhe i shkroi këto gjëra: dhe **ne** e dimë se dëshmia e tij është e vërtetë.

KUSH ËSHTË “NE” DHE “UNË”

25 Ekzistojnë edhe shumë gjëra tjera, të cilat i bëri Jezui, dhe sikur të gjitha të shkrubeshin, unë supozoj se e tërë bota vet nuk do t'i nxinte librat të cilat do të shkrubeshin për të. Amin.

ÇFARË EGZAGJËRIMI!

LIBRAT E BIBLËS

GENESIS

Autori: Njeri nga “pesë librat e Musait” EXODUS

Autori: Përgjithësisht i besohet

Musait

LEBITICUS

Autori: Përgjithësisht i besohet Musait

NUMBERS

Autori: Përgjithësisht i besohet Musait

DEUTERONOMY

Autori: Përgjithësisht i besohet Musait

JOSHUA

Autori: Pjesa kryesore i besohet Joshuas

JUDGES

Autori: Sigurisht Samuili

RUTH

Autori” nuk dihet sigurisht

FIRST SAMUILI I

Autori: i panjohur

SECOND SAMUILI II

Autori: i panjohur

FIRST KINGS(Mbretrit e Parë)

Autori: i panjohur

SECOND KINGS

(mbretërit e Dytë) Autor: i panjohur

EZRA

Autori: padyshim,dhe edituar nga Ezra

ESTHER

Autori: i panjohur

JOB

Autori: i panjohur

PSALMET

Autori: kryesisht Davidi, edhe pse ka autorë të tjerë

ECCESIASTES

Autori: i dyshimtë, por rëndom atribuohet Sollomonit

ISALAH

Autori: Kryesisht i besohet Isaiahut. Por pjesërisht ndodh të jetë shkruar nga dikush tjetër

JONAH

Autori: i panjohur

HABBAKUK

Autori: Asgjë nuk dihet për Vendlindjen ose kohën kur ka lindur

FIRST CRONICLES

(Kronikat e Para) Autori: i panjohur Sigurisht mbledhur dhe Botuar në Ezra

SECOND CHRONICLES

(Kronikat e dyta)

Autori: Gjithashtu mbledhur dhe edituar në Ezra

FAKTET E LARTËPËRMENDURA JANË NGA COLLINS
R. S. V. 1971. Faqet 12 – 17

Dhe kështu vazhdon tregimi ... Autorët e këtyre librave anonime ose janë “TË PANJOHUR” ose “PADYSHIM” ose “TË NJEJTTT” (të ngjashëm) ose janë me origjinë “TË DYSHIMTË”.

EPILOGU

Prej tani lexuesi, i cili ka një mendje të shëndoshë duhet të binde se Bibla nuk është ajo çka pohohet nga protagonistët e Krishterimit.

Më se dyzet vite isha i pyetur nga njerëzit x se prej nga posedojnë një dituri “aq të gjerë” për biblën dhe Krishterimin.

Thënë singërisht, pozita ime e tanishme si “ekspert” mysliman në Judizëm dhe Krishtërim nuk varet nga vullneti im. Kam qenë i detyruar të bëhem ky që jam.

PROVOKIM I HERSHËM

Ishte viti 1939, unë punoja si shitës në Misionin e Adamit, afër seminarit krishter po me këtë emër, shkolloheshin nxënësit për priftërinjë, ku unë dhe shokët e mij, punëtorët myslimanë, ishim në nishan të njerëzve aspirues të modës. Asnjë ditë nuk kalonte që mua dhe shokët e mij të besimit të besimit, të mos na fyejnë këta krishterë të rinj. Ata fyenin Islamin, Profetin e Shenjtë dhe Kur'anin.

Duke qenë një njëzet vjeçar i ndershëm, shumë natë të gjata i kalova pa gjumë, me lotë në sy, për arsye se nuk isha në gjendje t'a mbrojtë njeriun më të dashur se sa jetën “MËSHIRËN E TËRË NJERËZIMIT – MUHAMEDIN A.S. “Unë vendosa ta studioj Kur'anin, Biblën dhe literaturën tjetër. Kur e zbulova librin “IZ-HARUL HAQ” – e bëra një kthesë të madhe në jetën time. Pas

pak kohe u aftësova që t'i përfitojë misionarët e kolegjit Misionar të adamsit, dhe t'i shtyej ata të djersitën nën qafë derisa të fillojnë me respekt të sillen ndaj islamit dhe Apostulit të tij të Shenjtë.

MYSLIMANËT PËRHERË TË ATAKUAR

Një gjë më shtyen të mendohem se si aq shumë mysliman symbylltë vazhdimisht po sulmohen nga evangjelistët krishterë, të cilët e bartin luftën derë pas dere, dhe të cilët ftoheshin brenda nga mikpritësit pralluer myslimanë. Mendoja se sa pa mëshirë bluanin këta misionarë dhe llomotitnin kundër myslimanëve me shënime të rrejshme për fenë e tyre.

I vendosur që në shtëpinë e myslimanëve të sjelli të drejtat e tyre për t'u mbrojtur dhe t'iu ofroj dituri për të kundërshtuar ungjilluesit e nxehtë, përderësit e krishterimit dhe fyesit e paturpshëm të Islamizmit dhe Apostolit të tij të Shenjtë. Unë, përvuejtësisht, ndërmora të mbaj ligjëratat për t' treguar masës myslimane se nuk kanë arsye të frikohen nga sulmuesit krishterë.

Ligjëratat e mia, gjithashtu, ishin një ftesë për krishterët që të dëshmojnë të vërtetën e Islamizmit dhe shpifjet, të cilat kanë depërtuar në mesin e së vërtetës të Jezuit (p.q.m.t.)

ATAKU NUK ISHTE I RI

Misionarët krishterë gjatë 100 viteve të fundit kanë vënë në dyshim myslimanët për shumë aspekte, edhe një numër i madh i këtyre dyshimeve, sipas meje, janë marrë si përgjigje e plotë ose e pjesërishtme. Ndoshta me dëshirë të Allahut, kontributi im në këtë lëmi, mund të jetë një përgjigje ose pjesë e saj, për këto dyshime të zhvlerësuesve të Islamit. Është shumë i rëndësishëm fakti që ne nuk heqim dorë!

Një sfidë e tillë i vie në mendje Geo G. Harris (G. Xh. Haris) autorit të “HOW TO LEAD MUSLIMS TO CHRIST” (SI T’I SHPIEJMË MYSLIMANËT TEK KRISHTI?). Ky misionar i cili u përpoq t’i konvertojë myslimanët e Kinës, në mënyrë shumë arrogante dhe të përmbledhur, e thotë këtë në faqen 19, me titullin – “THE THEORY OR CHARGE OF CORRUPTION” (TEORIA OSE NGARKIMI ME KORRUPCION)

“NE TANI KEMI ARRITUR NË SHKALLË MË SERIOZE NGA KËRCNIMI MYSLIMAN KUNDËR SHKRIMEVE TONA KRISHTERE! EKZISTON! TRI ASPEKTE TË KËSAJ NGARKESE”.

1. “Se dorëshkrimet krishtere kanë ndryshuar aq shumë sa që peshojnë pak nëse ndonjë ngjajshmëri e Ungjillit të famshëm lavdërohen në Kur’an. Kjo është përgjigje për njërin nga pyetjet vijuese. Ku janë bërë këto ndryshime? A mund ta gjeni ju një kopje të Ungjillit të Vërtetë , dhe të ma tregoni në mënyrë që të mund ta bëjë krahasimin me këtë që kam. “Në të cilën datë të historisë hyri

në qarkullim Ungjilli i pandryshueshëm?

2. “Se Ungjihtë tanë kanë përjetuar një korrupsion. Pesë pyetjet vijuese janë të përcaktuara dhe ne kemi të drejtë t’i shtrojmë ato.

- a) A ishte ky një korrupsion apo ndryshim me qëllim?
- b) A mund ta vëreni një paragraf të tillë në Biblën time?
- c) Si lexohet ky paragraf në mënyrë origjinale?
- ç) Kur, kush, si dhe pse u korrupsionua apo kush e ndërroi atë?
- d) A ishte ky një korrupsion i tekstit apo i kuptimit?

dh) Se, Ungjihtë tanë janë zëvendësim i “shtrembëruar” i Ungjillit origjinal.

3. Ose, Ungjihtë tonë janë veprim i njerëzve, e jo Ungjilli Fisnik, i cili zbriti nga Jezui. Një shqyrtim i vogël do ta zbulonte situatën e vërtetë, dhe rëndom mysliman, i cili bën padi është injorant i Biblës ose i Dhjatës së Re, ashtu si ka ekzistuar në të kaluarën apo si ekziston sot.

5. PARA SE TË VAZHDOJMË GJYSMËN E DYTË TË DIKUTIMIT, ËSHTË I RËNDËSISHËM NJË PËRKUJTUES, SE POSA NJË KUNDËRSHTAR DËSHIRON TA KUPTOJË NJË MENDJELEHTËSI TË NJË PADIE TË TILLË, NE NË SHTËPITË TONA DO T’I SHTYPIM DISA MËSIMET NGA DORËSHKRIMET TONA DHE ORVATJA JONË DO TË ISHTE POZITIVE E JO NEGATIVE.

A KANË MYSLIMANËT PËRGJIGJE?

A kemi ne myslimanët ndonjë përgjigje për këto pyetje? Nëse ju lexues të nderuar e keni lexuar këtë libër më vëmendje, atëherë ju do të pranoni se geo G. Harris nuk ka këmbë të qëndrojnë. Unë u përpoqa t'i jap faqet aktuale nga bibla për t'a demantuar pohimin e tij.

MYSLIMANËT THËRRASIN NË GARË

Në faqen 16, të librit të geo. G. Harris, ai u mëson shokëve të tij një rregull misionare me qëllim që ta marginalizojë pespektivën myslimane.

“Në këtë kaptinë është ngarkuar çështja e besueshmërisë dhe e vërtetës e njëmendtë e dorëshkrimit tonë është ngritur nga myslimanët. Para se të mbrojmë pozitën tonë, ky është një rast i cili na tregon se në mendjen tonë duhet ta ngulisim një rregull themelore”BARA E SË VËRTETËS I MBETET MYSLIMANIT.¹⁸

I qofsha falë Zotit që, për 40 vitet e demantimit të së vërtetës së Biblës, të cilën aq shumë e kërkuan krishterët, erdhi dita ime.

Mbani mend se ne myslimanët nuk shkojmë derë më derë për ta shitur fenë tonë. Derisa krishterët me propagandën fetare të tyre

¹⁸ EL HAMDU- LIL-LAH (lutja i drejtohet Zotit), lexuesi pajtohet se në këtë dhe të gjitha publikimet tjera, të dhëna në kopertinën e fundit të librit, vazhdimisht i kemi takuar këto padi krishtere.

cenojnë vetminë dhe paqën tonë dhe keqpërdorin mikëpritjen tonë dhe trazojmë myslimanët e papërgatitur.

Ata të cilët frikësohen ta demonstrojnë të vërtetën në rastet e provokimit nga këta krishterë, të cilët i tejkalojnë kufijtë me ofendimet që i bëjnë të dashurit tonë Muhamedit (S.A.V.), duhet ta rishqyrtojnë Imanin e tyre.

Dëshirojë që ligjeratat e mia të depërtojnë deri tek këta misionarë tinzakë, të cilët e sulmojnë shtëpinë dhe vatrën e myslimanit të padyshimtë, i cili e shikon vetëm punën e vetë.

Ligjeratat e mia, gjithashtu, kanë për qëllim përmirësimin e dinjitetit të shkatërruar të myslimanëve, të cilët ishin të lënduar nga sulmet e pabazë të propaguesve krishterë. Pyetni myslimanët e gjorë të Chatsworth Parkut të Hanoverit ose të Riverleasit (qytete në Afrikën e Jugut)¹⁹ se si u janë kundërvënë trysnisë së misionarëve të këtillë.

Nëse ky kontribut modest "A është Bibla Fjalë e Zotit?", gjen vend në shtëpitë e myslimanëve si mburojë kundër kërcnimit të misionarëve, atëherë orvatjet e mia do të shpërblehen shumë.

Shpërblimi do të ishte edhe më i madh po që se një dijetar i Jezuit (paqa qoftë mbi Të) do të udhëhiqet nga e drejta dhe do të largohet nga shpifja dhe thashethemet.

Shpërblimi më i madh, natyrisht i takon Allahut, të cilit unë i

¹⁹ Këto janë vetëm disa nga qytetet në të cilat myslimanët e gjorë detyrohen të jetojnë sipas ligjit të Afrikës Jugore. "Group Areas Act" (ligji i rezervave për banorë jo të bardhë)

lutem me ngulm për udhëzimin dhe mëshirën, dhe lutjet e mia dhe dëshirën time, dhe i cili i pranon orvatjet e mia të cilat ia kushtoi ATIJ, me tërë përvulësinë time.